



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Punës  
dhe Politikës Sociale



Република Северна Македонија  
Државен завод за статистика  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Enti shtetëror i statistikës



European Institute  
for Gender Equality




# INDEKSI I BARAZISË GJINORE NË MAQEDONINË E VERIUT

## 2022





**INDEKSI I  
BARAZISË  
GJINORE  
NË MAQEDONINË E VERIUT  
2022**



Autore: Marija Bashevka

Lektorë: Bestel Dooel Shkup

Dizajni: Nita Haxhihamza Gashi

Indeksi Kombëtar i Barazisë Gjinore për Maqedoninë e Veriut është përpiluar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Institutin Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), në kuadër të bashkëpunimit me Institutin (EIGE) me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë përmes Instrumentit të Ndihmës Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian, financuar nga Komisioni Evropian. Raporti bazohet në metodologjinë dhe kornizën e Indeksit të Barazisë Gjinore për vitin 2017, të zhvilluar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE, <http://eige.europa.eu>) për Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij. Të dhënat e përdorura për përlogaritjen e Indeksit të Barazisë Gjinore të Maqedonisë së Veriut i referohen vitit 2019.

Ky Publikim nuk i pasqyron domosdoshmërisht opinionet ose pikëpamjet e Institutit Evropian për Barazinë Gjinore dhe asnjë person nuk merr përgjegjësi për përdorimin e informacioneve që i përmban ky publikim. As Instituti Evropian për Barazi Gjinore dhe asnjë person që vepron në emër të tij nuk mund të jetë përgjegjës për përdorimin e informacioneve që i përmban ky publikim. Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk i përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Zhvillimi dhe publikimi i këtij raporti është mbështetur në kuadër të projektit "Avansimi i institucionalizimit të ROB përmes integritit sistematik të perspektivës gjinore në planifikimin strategjik dhe programimin e institucioneve qeveritare në Maqedoninë e Veriut" të realizuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me mbështetjen e projektit të UN Women "Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut", financuar nga Zvicra dhe Suedia.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionet dhe pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose organizatave të tjera të lidhura. Kufijtë dhe emrat e deklaruar si dhe emërtimet e përdorura në hartat e këtij raporti nuk nënkuptojnë konfirmim ose pranim zyrtar nga Kombet e Bashkuara.



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Punës  
dhe Politikës Sociale



Република Северна Македонија  
Државен завод за статистика  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Enti shtetëror i statistikës



European Institute  
for Gender Equality



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



Funded by  
the European Union

# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtesave</b>	<b>VI</b>
<b>Parathënie</b>	<b>1</b>
<b>1. Hyrje</b>	<b>2</b>
Indeksi i Barazisë Gjinore	2
<i>Figura 1: Fushat e indeksit të barazisë gjinore</i>	2
<b>2. Indeksi i Barazisë Gjinore 2022</b>	<b>3</b>
2.1. Indeksi i Barazisë Gjinore në Maqedoninë e Veriut 2022 (bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme nga viti 2019)	3
<i>Grafiku 1: Indeksi i Barazisë Gjinore, i përmbledhur dhe sipas fushave, 2015-2019</i>	3
<i>Tabela 1: Indeksi i Barazisë Gjinore, i përmbledhur dhe sipas fushave, 2015-2019</i>	4
2.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)	4
<i>Grafiku 2: Indeksi i Barazisë Gjinore, Maqedonia e Veriut dhe mesatarja e BE-së, 2019</i>	4
<i>Grafiku 3: Indeksi i Barazisë Gjinore sipas fushave, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019</i>	4
<i>Grafiku 4: Indeksi i Barazisë gjinore, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2021), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)</i>	5
<i>Grafiku 5: Progresi i Indeksit të Barazisë Gjinore, Maqedonia e Veriut (2015-2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2015-2019) dhe Serbia (2014-2018)</i>	5
2.3. Ndryshimet në nivel legjislativ dhe politikash	6
<b>3. Fusha e Punës</b>	<b>8</b>
3.1. Statusi dhe ndryshimet	8
<i>Grafiku 6: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Punës, Maqedonia e Veriut 2015-2019</i>	8
<i>Tabela 2: Ekuivalenti i orarit të plotë të punës, shkalla e punësimit (% , popullata 15+)</i>	9
<i>Tabela 3: Kohëzgjatja e jetës së punës (vite)</i>	9
<i>Tabela 4: Ndarja sektoriale - të punësuar në arsim, shëndetësi dhe punë sociale (% , popullata 15+)</i>	9
<i>Tabela 5: Fleksibiliteti në punë (% , popullata 15+)</i>	9
3.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)	9
<i>Grafiku 7: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Punës, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019</i>	9
<i>Grafiku 8: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Punës, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)</i>	10

<b>4.Fusha e Parasë</b>	<b>12</b>
4.1. Statusi dhe ndryshimet	12
<i>Grafiku 9:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Parasë, Maqedonia e Veriut 2015 - 2019	12
<i>Tabela 6:</i> Fitimi mesatar mujor (Standardi i Fuqisë Blerëse)	13
<i>Tabela 7:</i> Të hyrat mesatare neto ekuivalente (Standardi i Fuqisë Blerëse)	13
<i>Tabela 8:</i> Mosekspozimi ndaj rrezikut të varfërisë (% , popullata 16+)	13
<i>Tabela 9:</i> Ndarja e të hyrave (S20/S80)	13
4.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)	13
<i>Grafiku 10:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Parasë, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019	13
<i>Grafiku 11:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Parasë, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)	14
<b>5.Fusha e Dijeve</b>	<b>15</b>
5.1. Statusi dhe ndryshimet	15
<i>Grafiku 12:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Dijeve, Maqedonia e Veriut 2015 - 20	15
<i>Tabela 10:</i> Persona me arsim të lartë (terciar) të përfunduar (% , popullata 15+)	16
<i>Tabela 11:</i> Persona që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal (% , popullata 15+)	16
<i>Tabela 12:</i> Studentë me arsim të lartë (terciar) në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale, shkencave humane dhe arteve (% , popullata 15+)	16
5.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)	16
<i>Grafiku 13:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Dijeve, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019	16
<i>Grafiku 14:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Dijeve, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)	17
<b>6.Fusha e Kohës</b>	<b>18</b>
6.1. Statusi dhe ndryshimet	18
<i>Grafiku 15:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Kohës, Maqedonia e Veriut 2015, nuk ka ndryshime për shkak të mungesës së të dhënave	18
<i>Tabela 13:</i> Tregues në nënfushën Aktivitetet e kujdesit	19
<i>Tabela 14:</i> Tregues në nënfushën Aktivitetet sociale	19
6.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2015)	19
<i>Grafiku 16:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Kohës, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2015	19
<i>Grafiku 17:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Kohës, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)	20

<b>7. Fusha e Pushtetit</b>	<b>21</b>
7.1. Statusi dhe ndryshimet	21
<i>Grafiku 18:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Pushtetit, Maqedonia e Veriut 2015 - 2019	21
<i>Tabela 15:</i> Tregues në nënfushën Pushteti politik	22
<i>Tabela 16:</i> Tregues në nënfushën Pushteti ekonomik	23
<i>Tabela 17:</i> Tregues në nënfushën Pushteti social	23
7.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)	23
<i>Grafiku 19:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Pushtetit, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019	23
<i>Grafiku 20:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Pushtetit, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)	24
<b>8. Fusha e Shëndetit</b>	<b>25</b>
8.1. Statusi dhe ndryshimet	25
<i>Grafiku 21:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Shëndetit, Maqedonia e Veriut 2015 - 2019	25
<i>Tabela 18:</i> Tregues në nënfushën Statusi	26
<i>Tabela 19:</i> Tregues në nënfushën Shprehitë	26
<i>Tabela 20:</i> Tregues në nënfushën Akses	26
8.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)	27
<i>Grafiku 22:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Shëndetit, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019	27
<i>Grafiku 23:</i> Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Shëndetit, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)	26
<b>9. Fusha e Dhunës</b>	<b>27</b>
9.1. Statusi	27
<i>Tabela 21:</i> Përhapja e dhunës ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, viti 2019 (%)	29
<b>10. Konkluzione përmbljedhëse</b>	<b>31</b>
<b>Aneksi 1</b>	<b>33</b>
<b>Referenca</b>	<b>46</b>

# Lista e shkurtesave

## Kodet e shteteve

<b>AT</b>	Austria
<b>BE</b>	Belgjika
<b>BG</b>	Bullgaria
<b>CY</b>	Qiproja
<b>CZ</b>	Republika Çeke
<b>DE</b>	Gjermania
<b>DK</b>	Danimarka
<b>EE</b>	Estonia
<b>EL</b>	Greqia
<b>ES</b>	Spanja
<b>FI</b>	Finlanda
<b>FR</b>	Franca
<b>HR</b>	Kroacia
<b>HU</b>	Hungaria
<b>IE</b>	Irlanda
<b>AL</b>	Shqipëria
<b>IT</b>	Italia
<b>LT</b>	Lituania
<b>LU</b>	Luksemburgu
<b>LV</b>	Letonia
<b>MK</b>	Maqedonia e Veriut
<b>MT</b>	Malta
<b>NL</b>	Holanda
<b>PL</b>	Polonia
<b>PT</b>	Portugalia
<b>RO</b>	Rumania
<b>SE</b>	Suedia
<b>SI</b>	Sllovenia
<b>SK</b>	Slovakia
<b>EU-27</b>	Mesatarja e Shteteve Anëtare të BE-së
<b>RS</b>	Serbia
<b>ME</b>	Mali i Zi

<b>CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave
<b>ESHS</b>	Enti Shtetëror i Statistikës
<b>EUROSTAT</b>	Institucioni Statistikor i BE
<b>EIGE</b>	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>MPPS</b>	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>FRA</b>	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore
<b>EQLS</b>	Sondazhi Evropian për Cilësinë e Jetës
<b>EWCS</b>	Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës
<b>WMID</b>	Gratë dhe Burrat në Pozita Vendimmarrëse
<b>p.p.</b>	Pikë-përqindje



# Parathënie

Barazia gjinore është prioritet dhe angazhim kyç i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Krijimi i një sistemi efikas ligjor dhe institucional për promovimin e barazisë gjinore është segment i domosdoshëm i procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian dhe një nga vlerat themelore të tij. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve, përforcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe vendosjen e mekanizmave për monitorim të vazhdueshëm të progresit drejt realizimit të qëllimeve për barazi gjinore.

Në mënyrë që politikat dhe masat për promovimin e barazisë gjinore të jenë efektive, nevojitet një monitorim i vazhdueshëm i ndikimit të tyre në grupe të ndryshme qytetarësh.

Indeksi i Barazisë Gjinore është një mjet për matjen e progresit të barazisë gjinore në vendet e BE-së dhe shtetet kandidate për në BE. Ky mjet është zhvilluar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore me seli në Vilnius të Lituanisë.

Indeksi i Barazisë Gjinore jep një pasqyrë më të qartë mbi fushat ku përmirësimi është më se i nevojshëm, në mënyrë që të krijohen masa më të mira dhe më efektive për promovimin e barazisë gjinore.

Vetëm kështu mund të promovojmë barazinë gjinore dhe, pikërisht të dhënat e raportit të dytë për Indeksin e Barazisë Gjinore të vitit 2022 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, do të na mundësojnë të monitorojmë procesin e zbatimit të politikave dhe masave për arritjen e barazisë gjinore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdon të angazhohet me përkushtim në promovimin e barazisë gjinore. Ndryshimet ligjore, hapja e Qendrës së parë Burimore për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor, krijimi i politikave për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, si UN Women, Bashkimi Evropian, Instituti për Barazi Gjinore, vazhdon me synimin për një shoqëri më të mirë për të gjithë.

**Jovanka Trençevska**

Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale  
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

# 1. Hyrje

Republika e Maqedonisë së Veriut po publikon Raportin e dytë për matjen e Indeksit të Barazisë Gjinore (në tekstin e mëtejshëm Indeksi) bazuar në metodologjinë e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) (EIGE, 2017a). Vlerat e Indeksit janë llogaritur në bazë të të dhënave të fundit të disponueshme nga viti 2019.<sup>1</sup> Treguesit e përdorur për përlllogaritjet e Indeksit të Barazisë Gjinore janë të harmonizuara me treguesit e BE-së, respektivisht 28 tregues nga gjithsej 31 sosh janë përdorur nga të njëjtat baza të dhënash të përdorura edhe nga BE-ja (Eurostat, Eurofound, baza e të dhënave për statistikat gjinore EIGE), ndërsa tre tregues në fushën e Shëndetit janë tregues proxy. Aneksi 1 përmban një pasqyrë të detajuar të burimeve të të dhënave të përdorura për treguesit e Indeksit. Raporti ofron një pasqyrë krahasuese të progresit të arritur në krahasim me matjen e mëparshme (të parë) të Indeksit për shtetin në vitin 2019 - llogaritjet e të cilit në atë kohë bazoheshin në të dhënat e vitit 2015. Po ashtu, ofrohet një pasqyrë krahasuese me rezultatet e Indeksit të Barazisë Gjinore të BE-së të publikuar në vitin 2021 (llogaritjet e të cilit janë bazuar në të dhënat e vitit 2019)<sup>2</sup>, si dhe me rezultatet e vendeve kandidatë në BE nga rajoni që kanë publikuar indekset e tyre të barazisë gjinore bazuar në metodologjinë EIGE (Shqipëria, Serbia dhe Mal i Zi). Analiza e detajuar e progresit në secilën prej fushave të caktuara të Indeksit është konceptuar në kapituj të veçantë në raportin e dedikuar për fushat dhe nënfushat që e përbëjnë Indeksin. Është e rëndësishme të theksohet se të dhënat e përdorura për përlllogaritjen e Indeksit nuk i referohen gjithmonë të njëjtit vit, sepse përdoren të dhënat e fundit të disponueshme për treguesit që janë pjesë e anketave të ndryshme me periudha të ndryshme të grumbullimit dhe publikimit të të dhënave. Pasqyra e detajuar dhe shpjegimi i secilit prej treguesve individualë të përdorur për përlllogaritjet e fushave të Indeksit gjenden në Aneksin 1.

Indeksi i Barazisë Gjinore është një tregues i përbërë që shërben si instrument për monitorimin e (pa)barazisë gjinore brenda Bashkimit Evropian (BE). Që nga viti 2016, disa vende nga rajoni, kandidatë për anëtarësim në BE, kanë miratuar metodologjinë EIGE për përlllogaritjen e Indeksit të Barazisë Gjinore dhe i kanë publikuar indekset e tyre, duke mundësuar kështu një pasqyrë krahasuese të progresit drejt barazisë gjinore me Shtetet Anëtare të BE-së. Deri më tani, Serbia ka publikuar tre raporte (të parin në vitin 2016), ndërsa për vendin tonë ky është Raporti i dytë, kurse Shqipëria (2019) dhe Mali i Zi (2020) kanë publikuar nga një raport duke njoftuar përgatitjet për matjet e reja. Duke pasur në dispozicion matjet e Indeksit të Barazisë Gjinore në vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor, mundësohet

monitorimi i vazhdueshëm krahasues i progresit të vendeve të rajonit dhe në krahasim me vendet anëtare të BE-së.

Ky raport është përpiluar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me mbështetjen e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) dhe të Organit të Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).

## Indeksi i Barazisë Gjinore

Indeksi i Barazisë Gjinore është një tregues i përbërë që mundëson matjen e konceptit kompleks të barazisë gjinore dhe monitorimin krahasues të progresit (EIGE, 2017a). Ky Indeks formohet duke kombinuar treguesit gjinorë në një masë të vetme të përbërë. Ai përbëhet nga gjashtë fusha thelbësore (Puna, Paraja, Dijet, Koha, Pushteti dhe Shëndeti) dhe dy fusha mbështetëse (Pabarazitë interseksionale dhe Dhuna) (Figurai 1). Secila prej fushave përbëhet nga nënfusha përmes të cilave përlllogariten rezultatet e përmbledhura totale të fushave. Indeksi i Barazisë Gjinore mat se sa larg (ose afër) janë Shtetet Anëtare nga arritja e barazisë së plotë gjinore. Ai jep rezultate si në nivel të Shteteve Anëtare po ashtu edhe në nivelin e mesatares së BE-së. Indeksi i Barazisë Gjinore i përlllogaritjet rezultatet për çdo fushë dhe nënfushë. Ai i mat edhe dallimet gjinore të përshtatura për shkallët e suksesit, ku dallimet gjinore nuk konsiderohen pozitive kur ato tregojnë një situatë negative për gratë ose burrat.

Indeksi mat si nivelin e progresit, po ashtu edhe hendequn gjinor në fusha të ndryshme. Rezultatet e Indeksit të Barazisë Gjinore maten përmes pikëve të arritura në një shkallë nga 1 deri në 100, ku 1-shi tregon pabarazi totale, kurse 100-shi përfaqëson arritjen e plotë të barazisë gjinore në vend. Vlerat e Indeksit afër shifrës 1 tregojnë një nivel të ulët arritjesh në fushë (për shembull, shkallë të ulët të përfundimit të arsimit të lartë) dhe një hendeq të lartë gjinor (ndryshime të theksuara në arritje midis grave dhe burrave), ndërsa vlerat e Indeksit afër 100 tregojnë arritje të larta në këtë fushë (për shembull, shkallë të lartë të përfundimit të arsimit të lartë) dhe hendeq të vogla ose të paekzistueshme gjinore midis grave dhe burrave.

Figura 1. Fushat e Indeksit të Barazisë Gjinore



<sup>1</sup> Raporti i parë i Barazisë Gjinore u publikua në vitin 2019, kurse përlllogaritjet bazoheshin në të dhënat e vitit 2015.

<sup>2</sup> Indeksi i BE-së për Barazinë Gjinore për vitin 2021, llogaritjet e të cilit bazohen në të dhënat e vitit 2019, është indeksi i fundit i disponueshëm i BE-së në kohën kur u kryen përlllogaritjet e Indeksit të dytë të Barazisë Gjinore të Maqedonisë së Veriut (2022).

## 2. Indeksi i Barazisë Gjinore 2022


### 2.1. Indeksi i Barazisë Gjinore në Maqedoninë e Veriut 2022 (bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme nga viti 2019)

Indeksi i Barazisë Gjinore në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 është 64.5 pikë nga 100 pika maksimale dhe ka një progres prej 2.5 pikësh krahasuar me matjen e fundit në vitin 2019. Nëse progresi zhvillohet me këtë ritëm (2,5 pikë progres çdo katër vjet<sup>3</sup>), vendit do t'i nevojiten rreth 57 vjet për të arritur barazinë gjinore në të gjitha fushat. Për krahasim, në nivelin e mesatares së BE-së, ritmi i progresit të deritanishëm është një pikë çdo dy vjet dhe konsiderohet si një ritëm i ngadaltë dhe i pamjaftueshëm i progresit për arritjen e barazisë gjinore në nivel të BE-së (EIGE, 2021). Sigurisht, ndryshimet dhe zhvillimi shoqëror nuk janë procese lineare dhe mund të përshpejtohen me politika të përshtatshme në një kontekst të volitshëm social-ekonomik në nivel të brendshëm dhe të jashtëm, por mund të ngadalësohen edhe si rezultat i politikave regresive në

aspektin e barazisë, por edhe në një kontekst të pavolitshëm në vend dhe global. Kjo është arsyeja pse kontinuiteti në matjen e progresit të Indeksit dhe fushave përbërëse të tij ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të qenë në gjendje të monitorohen ndryshimet, ndikimi i politikave dhe detektimi i fushave ku ka nevojë për avancimin e politikave dhe masave për barazi gjinore dhe zbatimimi i tyre në praktikë.

Nëse rezultatet e Indekseve ndiqen në secilën prej fushave, vërehet progres tek fushat Puna, Paraja, Dijet dhe Pushteti. Ka një ngecje në fushën e Kohës (për shkak të mungesës së të dhënave të reja) dhe në fushën e Shëndetit, ku ka një ndryshim të parëndësishëm (+ 0,1 pikë). Krahasuar me matjen e fundit, shteti nuk vëren kthim prapa në asnjë nga fushat që e përbëjnë Indeksin (tabela 1).

**Grafiku 1: Indeksi i Barazisë Gjinore, Maqedonia e Veriut, 2015-2019**



**Tabela 1: Indeksi i Barazisë Gjinore, i përmbledhur dhe sipas fushave, 2015-2019**


	2015	2019	Progresi (2015 - 2019)
<b>Indeksi i barazisë gjinore</b>	62	64,5	2,5
<b>Puna</b>	69,4	70,7	1,3
<b>Paraja</b>	62,1	64,3	2,2
<b>Dijet</b>	59,6	62,4	2,8
<b>Koha</b>	55,8	55,8	0
<b>Pushteti</b>	52,6	58,6	6,0
<b>Shëndeti</b>	87,1	87,2	0,1

<sup>3</sup> Të dhënat e përdorura për përllogaritjen e Indeksit në vitin 2019 janë të dhënat e fundit të disponueshme për treguesit nga viti 2015, ndërsa të dhënat e përdorura për përllogaritjen e Indeksit në vitin 2022 janë të dhënat e fundit të disponueshme nga viti 2019.

## 2.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)


Ashtu si në matjen e mëparshme të Indeksit, vendi është ende i pozicionuar pas mesatares së Shteteve Anëtare të BE-së (BE-27) me 3.5 pikë (grafiku 2). Është e rëndësishme të theksohet se hendeku është ngushtuar në krahasim me matjen e mëparshme, ku vendi ishte prapa mesatares me 4.2 pikë. Edhe pse është e nevojshme të ndiqet trendi i rezultateve të Indeksit në periudhën e ardhshme, megjithatë, matja ekzistuese tregon se vendi po ecën me një ritëm afërsisht të ngjashëm e progresi të ngadalshëm si Shtetet Anëtare të BE-së - gjë që tregon nevojën për përmirësim të ndjeshëm të politikave, praktikës dhe përkushtimit për barazinë gjinore në vend në periudhën në vijim (EIGE, 2021).

**Grafiku 2: Indeksi i Barazisë Gjinore, Maqedonia e Veriut dhe mesatarja e BE-së, 2019**



Duke krahasuar fushat, Maqedonia e Veriut sërish ka diferencën më të madhe me BE-në në fushën e Parasë (18,1 pikë) dhe fushën e Kohës (9,1 pikë), dhe dallimet më të vogla janë në fushën e Dijeve (0,3 pikë), Shëndetit (0,6 pikë) dhe Punës (0,9 pikë) (Grafiku 3). Ashtu si në matjen e mëparshme të Indeksit nga viti 2019, vendi ka një rezultat më të lartë se mesatarja e BE-së vetëm në fushën e Pushtetit (+3,6 pikë) (grafiku 3).


**Grafiku 3: Indeksi i Barazisë Gjinore sipas fushave, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019**



Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së, Maqedonia e Veriut këtë herë renditet në pozitën e katërbëdhjetë, mes Italisë (15) dhe Maltës (13) dhe ka përparuar një pozicion më lart në renditje krahasuar me vitin 2019 kur ishte e renditur në pozitën e pesëmbëdhjetë. Vendi mbetet pas mesatares së BE-së me 3.5 pikë dhe me 19.4 pikë pas shtetit më të mirë të renditur në BE - Suedisë (grafiku 4).


Krahasuar me matjen e fundit të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor që e publikojnë Indeksit, vendi ka një rezultat më të lartë se të tre vendet – Shqipëria (2020), Serbia (2021) dhe Mali i Zi (2019) (Grafiku 4).

**Grafiku 4: Indeksi i Barazisë Gjinore, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2021), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)**



Nëse monitorohet progresi në krahasim me matjen e vitit 2015, Maqedonia e Veriut është në grupin e shteteve me nivel të ulët progresi, respektivisht e shtata nga shtetet me progres deri në 3 pikë së bashku me Belgjikën (2,5 pikë) dhe Greqinë (2,4 pikë) (grafiku 5). Serbia, nga ana tjetër, bën pjesë në grupin e shteteve që tregojnë një nivel më të lartë progresi, me një rritje të Indeksit prej 5.6 pikësh në periudhën 2014-2018.<sup>4</sup>

**Grafiku 5: Progresi i Indeksit të Barazisë Gjinore, Maqedonia e Veriut (2015-2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2015-2019) dhe Serbia (2014-2018)**



<sup>4</sup> Përlogaritjet bazohen në të dhënat e vitit 2014 dhe 2018, në mënyrë adekuate për Indekset e publikuara në vitin 2016 dhe 2021/

## 2.3. Ndryshimet në nivel legjislativ dhe politikash

Në periudhën që nga publikimi i Indeksit të fundit në vitin 2019 me përlogaritje të bazuara në të dhënat e vitit 2015, vendi ka kaluar nëpër disa ndryshime të rëndësishme në aspektin e politikave dhe proceseve për promovimin e barazisë gjinore, në kontekstin kompleks të pandemisë me Virusin COVID-19, fillimi i agresionit ushtarak rus kundër Ukrainës dhe ngecjet e mëvonshme ekonomike. Megjithatë përlogaritjet e Indeksit të ri i përdorin të dhënat më të fundit të disponueshme nga viti 2019, në vijim jepet një pasqyrë e ndryshimeve në nivel politikash në periudhën pas vitit 2015 deri në momentin e finalizimit të këtij raporti. Rishikimi i ndryshimeve në nivel legjislativ dhe politikash i referohet në një masë të konsiderueshme rishikimit që e përmban Strategjia e re për Barazinë Gjinore 2022-2027 (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 170/2022).

Në periudhën e kaluar u zhvilluan debate ekspertësh, vlerësime dhe analiza mbi efektivitetin dhe funksionalitetin e mekanizmave institucionalë për barazi gjinore (makineria gjinore) dhe rezultatet e arritura me Ligjin ekzistues për Mundësi të Barabarta të Femrave dhe Meshkujve (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 6/2012 dhe nr. 150/2015). Analizat rezultuan me rekomandime për reformën e nevojshme të makinerisë gjinore dhe nevojën për harmonizim të mëtejshëm me standardet dhe direktivat ligjore ndërkombëtare dhe evropiane (Reaktor, 2020). Për këtë qëllim, në vitin 2019 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e filloi procesin e krijimit të ligjit të ri për barazi gjinore, duke formuar një Grup pune që e hartoi Projekt-ligjin për Barazi Gjinore, i cili pritet të miratohet në periudhën e ardhshme. (Reaktor, 2020).

Në korrik të vitit 2022 u miratua Strategjia e re për Barazinë Gjinore për periudhën 2022-2027 (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 170/2022), që është dokumenti strategjik bazë i vendit në fushën e barazisë gjinore, me të cilin vendoset udhërrëfyesi institucional i synimeve dhe aktiviteteve për promovimin e barazisë gjinore dhe avancimin e statusit të gruas në vend në periudhën e parashikuar të zbatimit.

Strategjia ndërlihet me Strategjinë e Barazisë Gjinore për periudhën 2013-2020 dhe fokusohet në tre objektiva të përgjithshme: 1. Krijimi i një sistemi efektiv dhe efikas për promovimin e barazisë gjinore në nivel qendror dhe lokal (objektivat specifike fokusohen në mekanizmat institucionalë në nivel qendror lokal); 2. Përmirësimi i pozitës së gruas në të gjitha fushat e jetës publike dhe private (qëllimet specifike u referohen fushave të tregut të punës, bujqësisë, pjesëmarrjes politike, kujdesit shëndetësor, arsimit, paqes, kulturës dhe sportit); dhe 3. Luftimi i stereotipave gjinorë dhe ndërtimi i një kulture të mosdhunës dhe mosdiskriminimit bazuar në gjininë dhe identitetin gjinor (me synime specifike të dedikuara për të luftuar dhunën me bazë gjinore dhe stereotipat gjinorë dhe seksizmin).

Në vitin 2020, u miratua Ligji i ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 258/2020), në të cilin diskriminimi interseksional njihet si formë më e rëndë e diskriminimit dhe identiteti gjinor, kurse orientimi seksual u shtua si bazë për diskriminim. Në vitin 2022, u miratua Strategjia e re Kombëtare për Barazi dhe Mosdiskriminim 2022-2026 (MPPS, 2022).

Përveç këtyre dokumenteve strategjike, në vitin 2021 u miratua edhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mbrojtjen, Promovimin dhe Përmbushjen e të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave Rome 2022-2024, i cili synon të promovojë drejtësinë interseksionale, respektivisht akses të barabartë dhe të drejtë në të drejta, mundësi, burime dhe fuqi në shoqëri, për gratë dhe vajzat rome (MPPS, 2021).

Në fushën e tregut të punës, me ndryshimet në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës në vitin 2015 u rregullua e drejta për pagë të barabartë për gratë dhe burrat, si dhe trajtimi i barabartë në punësim, kushtet e punës dhe skemat e sigurimit social (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 74/15). Vijon hartimi i një Ligji të ri për Marrëdhëniet e Punës, i cili synon të jetë në përputhje me Direktivën (BE) 2019/1158 për ekuilibrin midis jetës private dhe asaj të punës të prindërve dhe personave të përfshirë në përkujdesje (Official Journal of the EU, 188/79), me të cilin do të bëheshin reforma në sistemin aktual të pushimit të lehonisë dhe do të futej pushimi prindëror, që përfshin edhe të drejtën e veçantë për pushimin e babait, e që me legjislativon aktual fitohet vetëm me anulimin/ndërprerjen e së drejtës për pushim të lehonisë të nënës (MPPS, 2022). Krahas ndryshimeve ekzistuese dhe të planifikuara në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, në vitin 2017 është bërë një ndryshim i rëndësishëm ligjor në Ligjin për Pagën Minimale (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 11/12; 30/14; 180/14; 81/15; 129/15; dhe 132/17), ku u barazua paga minimale në industrinë e tekstilit, lëkurës dhe këpucëve (ku numri më i madh i të punësuarve janë gra) me nivelin e pagës minimale në industritë e tjera. Gjithashtu, po punohet për Ligjin e ri për Mbrojtjen nga Shqetësimi në Vendin e Punës (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 79/13) dhe pritet të rregullojë parandalimin dhe mbrojtjen nga shqetësimet psikologjike dhe seksuale në vendin e punës.

Me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen Sociale në vitin 2019 (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 104/19), u vendos reforma në sistemin e mbrojtjes sociale, me fokus më të madh në gratë dhe vajzat e marginalizuara dhe dispozita për ndihmë financiare dhe mbështetje për viktimat e dhunës. Gjithashtu, me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas nga viti 2019 (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 101/19) janë përfshirë edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhuna në familje, duke përfshirë edhe procedurat për mbrojtje sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në fushën e arsimit, në vitin 2019 është miratuar Ligji i ri për Arsimin Fillor (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 161/19) i cili ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, duke përfshirë bazën gjinore, orientimin seksual, identitetin gjinor, si dhe janë paraparë masa afirmative për tejkalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë në procesin arsimor. Në vitin 2018, megjithatë, me ndryshimet në Ligjin për Tekstet Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 98/2008; 99/2009; 83/10; 36/11; 135/11; 46/12; 24/13; 120/13; 29/14; 146/15; 217/15; 30/16; dhe 21/18) janë vendosur dekrete që synojnë sigurimin e materialeve mësimore me cilësi më të lartë pa përmbajtje diskriminuese, stereotipie dhe të pandjeshme gjinore. Si pjesë e masave për reduktimin e ndarjes gjinore në arsimin terciar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në vitin akademik 2019/2020 ka ndarë më shumë bursa për studentet femra (63,7 %) krahasuar me studentët meshkuj (36,3 %) për shkencat bioteknike, tekniko-teknologjike, natyrore-matematikore, teknologjitë e informacionit, matematikën dhe shkencat natyrore (MPPS, 2022). Për më tepër, pas përgatitjeve më të gjata, në vitin 2021 lënda për Edukim seksual gjithëpërfshirës u pilotua si lëndë zgjedhore në klasën e nëntë në arsimin fillor në dy shkolla fillore në Shkup dhe Tetovë.


Në aspektin e kujdesit shëndetësor, në vitin 2019 u miratua Ligji i ri për Ndërprerjen e Shtatzënisë (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 101/19), i cili i avancoi të drejtat dhe liritë riprodhuese dhe shëndetësore të grave (të kufizuara më parë nga ndryshimet kufizuese të paraqitura në ligji i mëparshëm i vitit 2013, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/13). Ligji i ri lejon edhe ndërprerjen e shtatzënisë me metodë medikamentoze dhe një të drejtë e pacenueshme të gruas për të vendosur në mënyrë të pavarur për ndërprerjen e shtatzënisë.

Në vitin 2017, Qeveria e ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2018, duke nisur kështu procesin e zbatimit të saj. Për më tepër, u hartua Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Stambollit 2018-2023, me udhëzime për monitorimin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me dispozitat e Konventës së Stambollit. Në përputhje me Planin e Veprimit, në vitin 2021 është miratuar Ligji i ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Femrës dhe Dhuna në Familje (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 24/21), i cili është në përputhje me rekomandimet e Konventës së Stambollit dhe synon zgjerimin e sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe në familje.

Pasqyra e ndryshimeve kryesore në legjislacion dhe politika në fushën e barazisë gjinore në vend tregon nivelin e progresit në kornizën ligjore dhe strategjike për avancimin e barazisë gjinore në vend. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, pavarësisht progresit në nivel normativ, zbatimi konsekuent në praktikë mbetet një sfidë në vete. Një pjesë e arsyeve kryesore për shkallën e pamjaftueshme të përmbushjes së detyrimeve të ndërmarra nga dokumentet kryesore strategjike në fushën përkatëse janë burimet e pamjaftueshme financiare për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të duhura (mungesa e një buxheti të caktuar enkas me një qëllim të veçantë) dhe mungesa e shpeshtë ose vlerësimi joadekuat i implikimeve fiskale për zbatimin e programeve dhe aktiviteteve kryesore strategjike. Sfidë shtesë është kompetenca, sistematizimi dhe ndikimi i personave përgjegjës për implementimin e aktiviteteve të ndryshme brenda institucioneve (koordinatorët për mundësi të barabarta), respektivisht aftësia e tyre për të kërkuar llogaridhënie të vazhdueshme dhe për të vendosur prioritete në përmbushjen e aktiviteteve, masave dhe programeve që ndërlidhen me barazinë gjinore në institucionet përkatëse. Krahas këtyre sfidave, mungon edhe një sistem gjithëpërfshirës për monitorimin e vazhdueshëm të progresit në arritjen e synimeve të përcaktuara me dokumentet ligjore dhe strategjike për avancimin e barazisë gjinore.



# 3. Fusha e Punës



Fusha e punës mat si është përfshirja e grave dhe burrave në tregun e punës dhe nëse ata kanë akses të barabartë në punësim cilësor dhe kushte të përshtatshme pune. Aksesin në punësim dhe cilësinë e kushteve të punës, si dhe diskriminimi dhe ndarja gjinore (horizontale dhe vertikale) janë një nga faktorët kryesorë nga të cilët varet qasja e barabartë në burimet ekonomike dhe ulja dhe eliminimi i varfërisë (EIGE, 2013). Fusha e Punës i mat dallimet gjinore në fushat që lidhen me tregun e punës përmes dy nënfushave, Pjesëmarrja dhe Ndarja dhe cilësia e punës.


Nënfusha Pjesëmarrja mat dallimet midis grave dhe burrave për sa i përket punësimit dhe kohëzgjatjes së jetës së punës. Matet nëpërmjet dy treguesve: treguesi i shkallës së punësimit (për popullatën e grupmoshës 15 vjeç+), ekuivalente me kohë të plotë pune; dhe treguesi i kohëzgjatjes së jetës së punës (për popullatën e grupmoshës 15 vjeç+). Treguesi i shkallës së punësimit, ekuivalentuar me kohën e plotë të punës, përfitohet duke krahasuar numrin mesatar të orëve të punës të çdo punonjësi me numrin mesatar të orëve të punës të një punonjësi me kohë të plotë pune (EIGE, 2017a).

Nënfusha e dytë përbëhet nga dy tregues – ndarja sektoriale (horizontale) dhe cilësia e punës. Ndarja horizontale është përqendrimi i grave dhe burrave në sektorë dhe profesione të caktuara të punës.<sup>5</sup> Matet nëpërmjet pjesëmarrjes së grave dhe burrave në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale si përqindje e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në të gjithë sektorët. Cilësia e punës matet përmes fleksibilitetit të punës dhe perspektivës së karrierës. Fleksibiliteti i punës matet me aftësinë e punonjësve për të

marrë një ose dy orë pushim gjatë orarit të punës për nevoja personale ose familjare. Perspektiva e karrierës, nga ana tjetër, matet përmes indeksit të perspektivës së karrierës, që e mat cilësinë e punës duke kombinuar treguesit e statusit të punësimit (i vetëpunësuar ose i punësuar), llojin e kontratës së punës, perceptimin e punonjësit për perspektivat e avancimit në karrierë dhe perceptimin e probabilitetit për humbjen e vendit të punës (EIGE, 2017a). Ajo matet në një shkallë nga 0 në 100 pikë, ku vlera më e lartë tregon një cilësi më të lartë të punës (perspektiva e karrierës).

## 3.1. Statusi dhe ndryshimet

**Grafiku 6: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Punës, Maqedonia e Veriut 2015 – 2019**



<sup>5</sup> Ndarja vertikale, nga ana tjetër, nënkupton përqendrimin e grave dhe burrave në nivele të ndryshme të përgjegjësisë së punës, pozitës dhe pushtetit dhe vendimmarrjes, nga të cilat lindin edhe nivele të ndryshme të përfitimeve financiare dhe shoqërore. Në matjen e Indeksit dhe vlerës së Fushës së Punës bën pjesë edhe indikatorin për ndarjen sektoriale (horizontale).



Rezultati i përgjithshëm në fushën e Punës është 70,7 pikë dhe paraqet përmirësim prej 1,3 pikësh krahasuar me Indeksit në këtë fushë nga viti 2015. Një ndryshim pozitiv vërehet në nënfushën Pjesëmarrja (një rritje prej tre pikësh krahasuar me vitin 2015), që kontribuon kryesisht në rritjen e Indeksit të përmbledhur të fushës së Punës. Në nënfushën Ndarja dhe cilësia e punës vërehet një rënie prej 0.4 pikë përqindjeje për shkak të korigjimeve të koeficienteve në përlllogaritje, që e marrin parasysh raportin midis burrave dhe grave dhe vlerën më të lartë midis vendeve.

Nëse analizohen treguesit që janë bazë për llogaritjen e Indekseve në fushën dhe nënfushat e Punës, ndryshimi më domethënës është në punësim, respektivisht shkalla e punësimit, ekuivalent me punën me kohë të plotë. Në fakt, edhe pse në periudhën vjetore 2015-2019 ka rritje të shkallës së punësimit si për gratë ashtu edhe për burrat, diferenca (hendeku) gjinore në normat e punësimit rritet nga 16.5 pikë përqindjeje në vitin 2015 në 18.3 pikë përqindjeje në vitin 2019 për shkak të rritjes më të lartë në punësimin e burrave krahasuar me gratë (tabela 2).

**Tabela 2: Orari i plotë i punës i ekuivalentuar, shkalla e punësimit (% , popullata 15+)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	32,5	49	-16,5
2019	35,9	54,2	-18,3

Megjithatë, treguesit, tregojnë gjithashtu se mesatarisht gratë kanë ende më pak gjasa të punësohen me kohë të plotë pune krahasuar me burrat dhe kohëgjatësia e tyre e punës është mesatarisht 10 vjet më e shkurtër se ajo e burrave (tabela 3).

**Tabela 3: Duration of working life (Vitis)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor
2015	25,1	36,9	-11,8
2019	26,4	36,8	-10,4

Në nënfushën Ndarja dhe cilësia e punës, ndryshimi i kushteve mund të monitorohet vetëm në treguesin e ndarjes sektoriale, ndërkohë që nuk ka të dhëna të reja për fleksibilitetin e punës dhe indeksin e perspektivave të karrierës që nga matja e fundit e Indeksit. Ndarja sektoriale tregon një përqendrim të lartë të punësimit të grave në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale. Në vitin 2019 ka vazhduar rritja e pjesëmarrjes së grave të punësuar në këta sektorë, krahasuar me pjesëmarrjen e burrave dhe, për rrjedhojë, ka një rritje të hendekut gjinor në ndarjen sektoriale krahasuar me vitin 2015 (tabela 4).

**Tabela 4: Ndarja sektoriale – të punësuar në arsim, shëndetësi dhe punë sociale (% , popullata 15+)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	19	5,9	13,1
2019	20	5,7	14,3


Treguesit e përdorur për fleksibilitetin e punës nga viti 2015 tregojnë se gratë që punojnë në Maqedoninë e Veriut mesatarisht kanë më pak fleksibilitet në kohën e punës krahasuar me burrat dhe, për rrjedhojë, më pak mundësi për balancë ndërmjet përgjegjësi të punës dhe jetës private (tabela 5). Ky aspekt është i rëndësishëm dhe për më tepër ka ndikim negativ në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, veçanërisht në një vend ku ka një shpërndarje të theksuar të pabarabartë të punës së papaguar, respektivisht obligimet shtëpiake dhe kujdesi ndaj fëmijëve që, në masë të madhe, e kryejnë gratë (ky aspekt është analizuar më hollësisht në fushën Koha).

**Tabela 5: Fleksibiliteti në punë (% , popullata 15+)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	41,1	44,2	-3,1

## 3.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)

**Grafiku 7: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Punës, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019**




Krahasuar me mesataren e BE-së, dallimi në fushën e Punës zvogëlohet nga 2.1 pikë në 0.9 pikë krahasuar me vitin 2015. Ka një përmirësim në rezultatet e kësaj fushe si në Maqedoninë e Veriut ashtu edhe në nivel të BE-së, por është më i theksuar në Maqedoninë e Veriut. Krahasuar me BE-në, diferenca është më e theksuar në nënfushën Pjesëmarrja (10.1 pikë) që, edhe pse ka rënë në krahasim me vitin 2015 (11.6 pikë), megjithatë tregon një ngecje të konsiderueshme prapa mesatares evropiane për sa i përket dallimeve gjinore në punësimin dhe kohëzgjatjen e jetës së punës.

Në nënfushën Ndarja dhe cilësia e punës nuk ka ndryshime për vendin që nga viti 2015 dhe rezultati është më i lartë se mesatarja evropiane. Në BE, nga ana tjetër, ka një përkeqësim të rezultatit në krahasim me vitin 2015 dhe

kjo ndikon në rritjen e diferencës në këtë nënfushë mes Maqedonisë së Veriut dhe mesatares së BE-së (BE-27), nga 6.7 pikë në 7.2 pikë krahasuar me vitin 2015.

Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e rajonit që e kanë publikuar Indeks, Maqedonia e Veriut renditet në vendin e tetëmbëdhjetë, afër, por nën mesataren e BE-së. Vendi shënon rezultate më të larta në fushën e Punës në krahasim me rezultatet e fundit të publikuara të Indeksit të Shteteve në rajon (Shqipëri, Serbi dhe Mal të Zi), por ende mbetet pas Suedisë - si vendi i renditur më lartë me 12.4 pikë. Grupi i vendeve me të cilat Maqedonia e Veriut ka vlera të përafërta në fushën e Punës janë kryesisht Shtete Anëtare të BE-së nga rajoni i Evropës Juglindore (Qiproja, Bullgaria, Rumania) ose nga ish-Jugosllavia (Kroacia, Serbia).

**Grafiku 8: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Punës, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)**



Ndonëse ka pasur disa përmirësime në fushën e Punës në krahasim me vitin 2015, ende ka pabarazi të konsiderueshme gjinore në këtë fushë në vendin tonë. Gratë kanë norma më të ulëta të aktivitetit në tregun e punës, norma më të ulëta punësimi dhe mesatarisht punojnë si punonjëse të papaguara të familjes më shpesh sesa burrat (Eurostat, 2022). Hendeku gjinor në punësim është më i lartë për gratë me nivel të ulët arsimor, gjë që tregon presion më të madh për gratë për të zotëruar kualifikime më të larta për të siguruar punësim, që nuk është rasti për burrat. Gjithashtu, prindërimi, vendbanimi (mjedis urban/rural), përkatësia etnike (veçanërisht tek gratë rome), si dhe statusi i personit me aftësi të kufizuara, ndikojnë më shumë

në aktivitetin ekonomik dhe rezultatet e punësimit për gratë sesa për burrat (ESHS, 2023; Eurostat, 2022; ESHS dhe UNICEF, 2020). Puna e papaguar në shtëpi dhe kujdesi për fëmijët, që kryhen kryesisht nga gratë (shih fushën e Kohës), paraqet gjithashtu një pengesë tjetër të rëndësishme për aktivitetin dhe punësimin e grave në tregun e punës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një kontekst ku mbizotërojnë normat dhe rolet tradicionale gjinore, ka disponueshmëri dhe cilësi të pamjaftueshme të shërbimeve në kopshte, mungesa e punës fleksibile dhe masave që mundësojnë përshtatjen ndaj detyrimeve familjare dhe të punës, mungesë e lejes së përbashkët prindërore, si dhe mbulim i pamjaftueshëm i pushimit të lehonisë që për-

jashton fermeret individuale të regjistruara<sup>6</sup>, si dhe nënat e papuna. Një tjetër pengesë me të cilën përballen gratë në tregun e punës është diskriminimi me bazë gjinore. Në vendin tonë, hulumtimet e bëra vënë në dukje përvojën e formave të ndryshme të diskriminimit me bazë gjinore në tregun e punës në mesin e 37 për qind të grave të anketuara dhe një prevalencë më të madhe të diskriminimit në sektorin privat (Leshoska dhe të tjerë, 2022). Përveç këtyre faktorëve, kufizimet që lidhen me transportin publik dhe lëvizshmërinë, sistemi tatimor, si dhe migrimi janë shtytës shtesë të rëndësishëm që ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës (Banka Botërore, 2017; 2020).

Këto aspekte i vënë në dukje faktorët ekzistues strukturorë që i kufizojnë mundësitë e barabarta për gratë për të marrë pjesë në tregun e punës. Në politikat dhe masat që i përmirësojnë parakushtet për rritjen e aktivitetit ekonomik të grave përfshijnë investime të vazhdueshme në infrastrukturën sociale (rritja e numrit dhe cilësisë së shërbimeve në kopshte, qendra të kujdesit për të rriturit), si dhe futja e lejes së përbashkët prindërore. Leja e përbashkët prindërore mundëson dhe inkurajon përfshirjen më të madhe të prindërve në kujdesin për fëmijët që në moshë të hershme, si dhe pjesëmarrje më të madhe në punët e shtëpisë pa pagesë. Leja e përbashkët prindërore e kombinuar me politika dhe masa të tjera që mundësojnë ekuilibrin e jetës së punës dhe jetës private (siç është puna fleksibël, puna hibride ose puna nga shtëpia) mundëson parakushte më të mira për aktivitetin e grave në tregun e punës dhe punësimin. Po ashtu, ky set politikash lejon ndryshimin gradual të të ashtuquajturës normë e "punëtorit ideal" (Williams, 2000), që supozon punëtorë që janë plotësisht të përkushtuar ndaj punës së tyre të paguar, pa përgjegjësi të tjera të mëdha, pa role prindërore ose nevojë për t'u kujdesur për persona të tjerë jashtë punës (që në masë të madhe e përmbushin kryesisht burrat, veçanërisht në shoqëritë ku punët e shtëpisë pa pagesë dhe kujdesi për fëmijët bëhen kryesisht nga gratë). Prandaj, ky set politikash ndikon potencialisht edhe në uljen e diskriminimit me bazë gjinore në tregun e punës, me të cilin gratë përballen shumë më tepër në krahasim me burrat, pikërisht për shkak të rolit të tyre kryesor në kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë. Përveç këtyre politikave, është e rëndësishme të investohet në transportin publik dhe infrastrukturën rrugore efikase dhe të aksesueshme, veçanërisht në zonat

rurale dhe periferike ku gratë përballen me akses të kufizuar në vendet e punës në lagjet dhe vendbanimet e tyre.


Të gjitha këto masa dhe politika të nënvizuara duhet të shoqërohen me investime të vazhdueshme në edukimin gjithëpërfshirës me ndjeshmëri gjinore që në moshë të hershme, për të parandaluar socializimin e hershëm dhe pranimin e normave dhe roleve të dëmshme tradicionale gjinore, si dhe për të promovuar barazinë dhe mundësitë e barabarta për të gjithë njerëzit në shoqëri, pavarësisht nga gjinia, identiteti gjinor, përkatësia etnike, kombësia, raca, aftësia e kufizuar, seksualiteti, klasa, religjioni apo ndonjë bazë tjetër.

Në vitet e fundit, investimet në kopshte të reja janë rritur, por ende ka mbulim të pamjaftueshëm të fëmijëve dhe kënaqësia me cilësinë e shërbimeve është në nivel të ulët (Leshoska dhe të tjerë, 2022).

Strategjia për Barazi Gjinore për periudhën 2022 - 2027 parasheh synimin specifik (2.1) për zvogëlimin e hendekut gjinor në pjesëmarrjen ekonomike të grave në tregun e punës, me një qasje interseksionale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 170/2022). Rezultatet e pritura synojnë rritjen e aktivitetit të grave në tregun e punës, me fokus të veçantë të grupeve të marginalizuara, uljen e hendekut gjinor në paga, uljen e ndarjes sektoriale dhe hierarkike të vendeve të punës, përmirësimin e cilësisë së punës, masat e vendosura për harmonizimin e jetës private dhe profesionale, në përputhje me Direktivën (BE) 2019/1158 për balancë të jetës private dhe profesionale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 170/2022). Krahas qëllimeve të përcaktuara gjerësisht dhe mungesës së objektivave dhe hapave specifikë për të arritur qëllimet dhe rezultatet e përcaktuara, Strategjia për Barazi Gjinore 2022-2027 ofron një kornizë të përgjithshme dhe udhëzime për institucionet kompetente për të përcaktuar dhe zhvilluar më tej masat dhe politikat specifike që do të përmirësojnë pjesëmarrjen ekonomike të grave dhe do të ndikojë në uljen e hendekut ekzistues gjinor në aktivitetin dhe punësimin e grave në tregun e punës.

<sup>6</sup> Vijon pilot-programi njëvjeçar (2023) i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, i cili mundëson pushim të lehonisë me pagesë për fermeret individuale të regjistruara. Megjithatë, kjo është një zgjidhje e përkohshme dhe nevojiten ndryshime të mëtejshme në legjislacionin për të mundësuar një zgjidhje të përhershme të së drejtës për pushim të paguar të lehonisë për fermeret individuale të regjistruara në vend (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 31/2023). Deri në mbylljen e këtij raporti nuk janë miratuar ndryshimet vligjore që garantojnë të drejtën e barabartë në pushim të lehonisë për fermeret si dhe për të punësuarit tjerë dhe personat e vetëpunësuar të përfshirë në Ligjin ekzistues për sigurim shëndetësor.

## 4. Fusha e Parasë




Fusha e Parasë mat pabarazitë gjinore në aksesin në burimet financiare dhe situatën ekonomike të grave dhe burrave (EIGE, 2013). Fusha e Parasë përbëhet nga dy nënfusha: nënfusha e Burimeve Financiare dhe nënfusha Situata Ekonomike.

Nënfusha e Burimeve Financiare mat pabarazitë gjinore në aksesin në burimet financiare përmes treguesve të fitimeve mesatare mujore dhe fitimeve mesatare neto të grave dhe burrave. Treguesi i të ardhurave mesatare mujore i referohet fitimeve nga puna, kurse i dyti përfaqëson të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara. Treguesi i dytë përllogaritet përmes të ardhurave të përgjithshme të familjes, ku përveç të ardhurave nga puna e paguar, përfshihen edhe pensionet, investimet, përfitimet sociale dhe burime të tjera të ardhurash pas taksave dhe zbritjeve të tjera (shpjegimi i detajuar në Aneksin 1). Të dy treguesit shprehen në nivelin e standardit të fuqisë blerëse, gjë që lejon krahasueshmëri të mëtejshme me shtetet tjera.

Nënfusha e dytë, Situata Ekonomike, përbëhet nga tregues që matin rrezikun e varfërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave midis grave dhe burrave. Treguesi i parë llogaritet përqindjen e personave që nuk janë në rrezik të varfërisë (që fitojnë të ardhura neto të barabarta ose më të mëdha se 60 për qind e të ardhurave mesatare kombëtare ekuivalente). Treguesi i dytë është raporti i kuintilit të të ardhurave dhe mat shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave midis grave dhe burrave.

### 4.1. Statusi dhe ndryshimet

**Grafiku 9: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Parasë, Maqedonia e Veriut, 2015 - 2019**



Vlera e rezultatit të përmblodhur e fushës së Parasë është 64.3 pikë për vitin 2019 dhe është rritur me 2.2 pikë krahasuar me vitin 2015. Përmirësimi i rezultatit të përmblodhur të kësaj fushe është rezultat i përmirësimit të vlerave të Indeksit në të dy nënfushat, në nënfushën Burimet financiare me 1,8 pikë dhe në nënfushën Situata ekonomike me 2,7 pikë krahasuar me rezultatet e vitit 2015. (grafiku 9). Megjithatë, rezultatet e Indeksit në fushën e Parasë tregojnë ende pabarazi të theksuar gjinore dhe një pozitë më të dobët ekonomike të grave në vend.

Ndonëse ka një përmirësim të rezultatit në nënfushën e Burimeve Financiare në krahasim me vitin 2015, megjithatë, vlera e Indeksit tregon një pabarazi gjinore ende të lartë që nënkupton një pozicion shumë më pak të favorshëm të grave në aksesin e burimeve financiare (fitimet mesatare mujore dhe të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara).

Vlerat e treguesve individualë për vitin 2019 tregojnë se, pavarësisht përmirësimeve në fitimet mesatare mujore dhe fitimet mesatare ekuivalente neto të grave dhe burrave në krahasim me vitin 2015, sërish mesatarisht fitimet dhe të ardhurat e disponueshme të grave janë më të ulëta në krahasim me mesataren e burrave (tabela 6 dhe tabela 7).

**Tabela 6: Fitimi mesatar mujor (Standardi i Fuqisë Blerëse)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor
2015	1003	1108	-105
2018	1067	1275	-208

**Tabela 7: Të hyrat mesatare neto ekuivalente (Standardi i Fuqisë Blerëse)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor
2015	5359	5434	-75
2019	6241	6360	-119

Treguesit në nënfushën Situata ekonomike regjistrojnë një përqendrim të caktuar të përqindjes së grave dhe burrave të rrezikuar nga varfëria, por edhe një përmirësim të shpërndarjes së të ardhurave midis grave dhe burrave krahasuar me vitin 2015. Treguesi i ekspozimit ndaj rrezikut të varfërisë tregon se, krahasuar me vitin 2015, ka një rritje të parëndësishme të ekspozimit ndaj rrezikut të varfërisë si për gratë (0.4 pikë përqindje) ashtu edhe për burrat (0.3 pikë përqindje), por rritja është më e theksuar për gratë (20.5 për qind e grave dhe 20.2 për qind e burrave në rrezik të varfërisë).

**Tabela 8: Mosekspozimi ndaj rrezikut të varfërisë (% populata 16+)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	79,9	80,1	-0,2
2019	79,5	79,8	-0,3


Treguesi i dytë nga nënfusha Situata Ekonomike që mat pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave shënon rënie në vitin 2019 krahasuar me matjen e fundit në vitin 2015 dhe është në të njëjtin nivel si për burrat ashtu edhe për gratë (tabela 9).

**Tabela 9: Ndarja e të hyrave (S20/S80)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor
2015	15,8	15,5	0,3
2019	18	18	0

## 4.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)


**Grafiku 10: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Parasë, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019**



Krahasuar me fushat e tjera të Indeksit të Barazisë Gjinore, vendi sërish mbetet prapa mesatares së BE-së pikërisht në fushën e Parasë. Dallimi domethënës është kryesisht për shkak të pabarazisë së theksuar gjinore në nënfushën e Burimeve financiare, ku Maqedonia e Veriut mbetet pas BE-së me 28.4 pikë (grafiku 10).

Diferenca në rezultatit ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe mesatares së vendeve të BE-së është rritur nga 17,5 pikë në vitin 2015 në 18,1 pikë në vitin 2019, duke shënuar progres më të ngadaltë në Maqedoninë e Veriut, ndërkohë që ka më shumë progres drejt barazisë gjinore në këtë fushë midis Shteteve Anëtare të BE-së. Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së, si dhe me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut renditet në vendin e 28-të, respektivisht ka rezultat më të ulët në fushën e Parasë. Vendi ka rezultat më të lartë vetëm prej vendeve të rajonit (Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi) dhe mbetet me 28.1 pikë pas Suedisë si vendi i renditur më lartë në BE (grafiku 11).


**Grafiku 11: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Parasë, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)**



Gratë në Maqedoninë e Veriut fitojnë më pak dhe janë në rrezik më të lartë të varfërisë në krahasim me burrat. Të ardhurat më të ulëta, jetëgjatësia më e shkurtër e punës dhe pasiviteti i lartë i tregut të punës kontribuojnë në një rrezik më të lartë të varfërisë, në pasiguri më të madhe ekonomike dhe në përkeqësim të perspektivës financiare për gratë në çdo fazë të jetës së tyre, veçanërisht në vitet e mëvonshme. Përveç politikave që janë relevante për përmirësimin e aktivitetit ekonomik të grave që diskutohet në fushën e Punës, nevojiten përparime shtesë të politikave për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore që kontribuon në hendekun e pagave gjinore (paga më e ulët për gratë në krahasim me burrat për të njëjtin nivel kualifikimi, arsimimi, i njëjti pozicion pune ose punë me të njëjtën vlerë). Është e nevojshme të përmirësohet Ligji ekzistues për Marrëdhëniet e Punës, i cili përveç dispozitave për pagë të barabartë për punë të barabartë, duhet të përmbajë edhe dispozita të qarta për pagë të barabartë për punë me vlerë të njëjtë (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 151/21).

Në Strategjinë për Barazi Gjinore 2022 - 2027, përmes objektivit specifik (2.1) zvogëlimi i hendekut gjinor në pjesëmarrjen ekonomike të grave dhe në tregun e punës, është paraparë fokusi në uljen e hendekut gjinor në paga (Gazeta Zyrtare e RMV, nr 170/2022). Megjithatë, për të arritur qëllimin, nevojiten masa dhe politika të specifikuar, si dhe tregues shtesë për monitorimin e progresit. Në këtë drejtim, Indeksi i Barazisë Gjinore shërben si një mjet i dobishëm për monitorimin dhe vlerësimin e efekteve të politikave ekzistuese dhe zbatimin e tyre dhe, në këtë mënyrë, ndihmon për planifikimin më të mirë të mëtejshëm për avancimin e barazisë gjinore në këtë fushë.

# 5. Fusha e Dijeve




Fusha e Dijeve mat pabarazitë gjinore në shkallën e arritjeve arsimore, pjesëmarrjen në procesin arsimor, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ndarjen gjinore. Kjo fushë përbëhet nga dy nënfusha: nënfusha e Arsimit të përfunduar dhe pjesëmarrjes dhe nënfusha e Ndarjes.

Nënfusha e Arsimit të përfunduar dhe pjesëmarrja i monitoron dallimet në nivelin më të lartë të arsimimit të arritur nga gratë dhe burrat, si dhe pjesëmarrjen e tyre në arsimin formal dhe joformal për të përvetësuar njohuri, shkathtësi dhe kompetenca në fusha të ndryshme. Përlllogaritet përmes treguesit për të diplomuarit e arimit të lartë (terciar) (si % e popullatës së moshës 15+) dhe treguesit për të mësuarit gjatë gjithë jetës që tregon përqindjen e grave dhe burrave që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal. Nënfusha e Ndarjes mat ndarjen gjinore në arsimin e lartë (terciar) përmes përqindjeve të studentëve (femra dhe meshkuj) që studiojnë në fushat e arimit, shëndetësisë, punës sociale, shkencave humane dhe arteve.

## 5.1. Statusi dhe ndryshimet

**Grafiku 12: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Dijeve, Maqedonia e Veriut 2015 - 2019**



Fusha e Dijeve shënon një rritje të Indeksit në krahasim me vitin 2015 me 2.8 pikë dhe ka progresin më të madh krahasuar me fushat e tjera (grafiku 12). Rritje ka në të dyja nënfushat krahasuar me vitin 2015, me progres më të theksuar në nënfushën e Ndarjes (+4,4 pikë). Përmirësimi i rezultatit në fushën e Dijeve reflekton, para së gjithash, ndryshimet pozitive në rritjen e personave me arsim të lartë (burra dhe gra), si dhe rritjen e studentëve që studiojnë në fushën e arimit, shëndetësisë dhe punës sociale, shkencat humane dhe artet. Hendeku gjinor në fushën e Dijeve është unik në krahasim me pesë fushat e tjera të Indeksit, ku pabarazia gjinore është rezultat i shkallëve më të larta të pjesëmarrjes së grave në krahasim me burrat, veçanërisht e reflektuar në nënfushën Arsimit të përfunduar dhe Pjesëmarrja.



Treguesit e nënfushës Arsim i përfunduar dhe pjesëmarrje tregojnë një pjesëmarrje më të lartë të grave në procesin arsimor (arsim formal ose joformal), si dhe një përqindje më të lartë të grave me arsim të lartë të fituar krahasuar me burrat (tabela 10 dhe tabela 11). Pjesëmarrja e personave me arsim të lartë të përfunduar është në rritje si te femrat ashtu edhe te meshkujt krahasuar me vitin 2015, megjithëse mbetet më e lartë tek femrat (tabela 10). Këto rezultate e pasqyrojnë tendencën e rritjes së numrit të të diplomuarave femra në arsimin e lartë kundrejt numrit të të diplomuarve meshkuj, të pranishëm në dekadën e fundit.

**Tabela 10: Persona me arsim të lartë (terciar) të përfunduar (% , popullata 15+)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	17,1	15	2,1
2019	18,5	16,8	1,7

Përqindja e personave që marrin pjesë në arsimin formal apo joformal në vitin 2019 është në rënie si për femrat ashtu edhe për meshkujt, megjithatë pjesëmarrja e femrave është më e lartë, sikurse në vitin 2015 (tabela 11).

**Tabela 11: Persona që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal (% , popullata 15+)**

Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	12,5	12,3	0,2
2019	12,1	11,7	0,4

Ndonëse përqindja e studentëve është në rritje si për femrat ashtu edhe për meshkujt krahasuar me vitin 2015, megjithatë, treguesi i Ndarjes tregon një ndryshim më domethënës në përqindjen e studenteve femra kundrejt studentëve meshkuj që studiojnë në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale, shkencave humane dhe arteve edhe në vitin 2019 (tabela 12). Monitorimi i këtij treguesi është i rëndësishëm si një refleksion i ndryshimeve në lidhje me orientimet tradicionale profesionale të nxitura nga rolet dhe normat tradicionale gjinore. Përfaqësimi më i lartë i femrave në fushat e përmendura tregon një nivel ende të lartë përqendrimi (ndarje) të femrave në fushat që konsiderohen tradicionalisht femërore dhe me të ardhura më të ulëta (të dedikuara për kujdesje, ndihmë, mbështetje, marrëdhënie shoqërore etj.), në krahasim me shkencat natyrore, teknologjinë dhe inxhinierinë si fusha me të ardhura më të larta, profesione që shihen si e ardhmja e zhvillimit dhe drejt të cilave burrat dhe djemtë inkurajohen më shumë të ndjekin arsimin dhe karrierën e tyre.

**Tabela 12: Studentë me arsim të lartë (terciar) në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale, shkencave humane dhe arteve (% , popullata 15+)**


Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	39,9	22,9	17
2019	45,1	26,1	19

Ashtu si në matjen e parë nga viti 2015, Indeksi për Barazinë Gjinore në fushën e Dijeve tregon nevojën për një përmirësim të konsiderueshëm të dallimeve midis grave dhe burrave në fushën e arsimit. Në veçanti, nevojiten përmirësime në drejtim të reduktimit të ndarjes në arsim sipas fushës ndërmjet grave dhe burrave dhe inkurajimit të pjesëmarrjes më të madhe të grave në fushat arsimore që lidhen me shkencat natyrore, teknologjinë dhe inxhinierinë.

Vendimet stereotipe gjinore në arsim ende po mbizotërojnë, por në dekadën e fundit gratë kanë zgjedhur gjithnjë e më shumë fushat STEM (shkencat e natyrës, teknologji, inxhinieri, matematikë), duke ulur hendekun gjinor në regjistrimin e studentëve në drejtimet e STEM nga 5.6 pikë përqindje në vitin 2013 në 3.8 pikë përqindje në 2020 (Eurostat, 2022). Krahas ofrimit të vendeve atraktive të punës në fushat STEM, një kontribut të caktuar në uljen e hendekut gjinor kanë dhënë edhe masat pozitive që janë zbatuar në periudhën e kaluar, si fushatat informative dhe bursat për mbështetjen e studenteve femra në fushat STEM (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 170/2022).

## 5.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)

**Grafiku 13: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Dijeve, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019**





Krahasuar me rezultatet e Indeksit në fushën e Dijeve në nivel të BE-së, Maqedonia e Veriut mbetet prapa me një diferencë të vogël prej 0.3 pikësh nga mesatarja e BE-së. Dallimi në rezultatin e përgjithshëm të Indeksit të fushën në fjalë me mesataren e BE-së është zvogëluar në krahasim me matjen e fundit, para së gjithash për shkak të përmirësimit të rezultatit të përgjithshëm në Maqedoninë e Veriut. Vlerat e Maqedonisë janë dukshëm më të ulëta në krahasim me BE-në në nënfushën Arsimi i përfunduar dhe pjesëmarrja (12 pikë), ndërsa në nënfushën Ndarja Maqedonia e Veriut ka rezultat më të mirë (+10,3 pikë), respektivisht pabarazi më të ulëta në krahasim me mesataren e BE-së (grafiku 13).


Dallimi i madh në nënfushën Arsimi i përfunduar dhe pjesëmarrja shpjegohet me përqindjet e ulëta të personave me arsim të lartë të fituar dhe personave që marrin pjesë në arsimin formal dhe joformal krahasuar me vendet anëtare të BE-së. Në fakt, nëse analizohen treguesit e vendeve të ndryshme anëtare të BE-së, vërehet se Maqedonia e Veriut ka ndër përqindjet më të ulëta të personave me arsim të lartë (tabela 10), mbi Rumaninë (14,1 për qind e femrave; 13,6 për qind e meshkujve) dhe afër treguesve të Republikës Çeke (19,5 për qind gra; 18,8 për qind gra), por shumë prapa Suedisë së renditur më mirë (42,8 për qind gra; 30,8 për qind

burra). Krahasuar me vendet e rajonit, vendi ka përqindje më të ulët të personave me arsim të lartë të përfunduar në krahasim me Serbinë dhe Malin e Zi. Me përjashtim të Gjermanisë, Holandës, Austrisë dhe Luksemburgut, në të gjitha shtetet e tjera anëtare të BE-së përqindja e grave me arsim të lartë e kalon atë të burrave, me hendekun më të lartë në Estoni (17.2 pikë përqindjeje).

Situata është e ngjashme me treguesin e pjesëmarrjes në arsimin formal ose joformal (tabela 11), ku Maqedonia e Veriut është në mesin e gjashtë vendeve të BE-së me normat më të ulëta (Bullgaria, Rumania, Sllovakia, Polonia, Kroacia, Greqia), shumë prapa vendeve më mirë të renditura, siç është Suedia (45.8 për qind gra; 31.6 për qind burra) dhe Finlanda (36.2 për qind gra; 29.1 për qind burra).

Sa i përket ndarjes, megjithëse është e shprehur në Maqedoninë e Veriut, megjithatë, hendeqet gjinore janë të larta edhe në nivel të BE-së, duke arritur një diferencë prej 33,1 pikë përqindje në Finlandë, 26,9 pikë përqindje në Estoni dhe 25,3 pikë përqindje në Slloveni. Rumania (15.2 pikë përqindje), Bullgaria (16.8 pikë përqindje), Luksemburgu (17.6 pikë përqindje) dhe Holanda (18.3 pikë përqindje) kanë dallime më të vogla se Maqedonia e Veriut (19 pikë përqindje).


**Grafiku 14: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Dijeve, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE-së (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)**



Nëse rezultati i Indeksit përmbljedhës në fushën e Dijeve krahasohet me rezultatet e Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut renditet e njëmbëdhjeta, pas Austrisë dhe mbi Finlandën, me rezultatin e Indeksit në fushën e Dijeve pak më poshtë mesatares së BE-së (grafiku 14). Maqedonia e

Veriut ka 12.8 pikë më pak se vendi më i renditur në fushën në fjalë - Suedia, dhe një rezultat përmbljedhës më të mirë të Indeksit se vendet e rajonit, me një rezultat 6.4 pikë më të lartë se Serbia, 6.8 pikë më shumë se Shqipëria dhe 7.3. pikë përqindjeje më të lartë se Mali i Zi (grafiku 14).

## 6. Fusha e Kohës




Mënyra se si njerëzit e kalojnë kohën e tyre dhe sa nga dita i kushtojnë punës me pagesë (zhvillimi i karrierës), aktivitetet shtëpiake dhe kujdesi për të tjerët (punë pa pagesë), si dhe aktivitetet për kënaqësinë dhe mirëqenien personale është një çështje e rëndësishme për barazinë gjinore dhe refleksionin e normave gjinore në shoqëri. Fusha e Kohës mat dhe gjurmon pabarazitë midis grave dhe burrave në kohën që ata shpenzojnë për punën e papaguar të shtëpisë dhe kujdesin e fëmijëve, si dhe kohën e shpenzuar për vullnetarizëm dhe rekreacion. Kjo fushë matet përmes dy nënfushave, si: nënfusha Aktivitetet e kujdesit dhe nënfusha Aktivitetet sociale.

Nënfusha e parë mat masën në të cilën gratë dhe burrat i kushtojnë kohë kujdesit për fëmijët dhe të rriturit dhe kryerjes së punëve të shtëpisë dhe matet nëpërmjet dy treguesve. I pari është treguesi i kohës që i kushtohet kujdesit që jep pasqyrë se sa për qind e grave dhe burrave caktojnë çdo ditë kohë për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve ose nipërve, kujdesin për të rriturit dhe personat e dobët ose personat që kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme në baza ditore. Treguesi i dytë mat se sa për qind e grave dhe burrave i kushtojnë kohën e përditshme punëve shtëpiake (të papaguara), si gatimi, mirëmbajtja e higjienës në shtëpi, organizimi i shtëpisë, larja, etj.

Nënfusha e dytë Aktivitetet sociale mat pabarazitë gjinore në kohën e shpenzuar në aktivitete kulturore, sportive, argëtuese dhe bamirëse dhe matet me dy tregues. Treguesi i parë mat përqindjen e grave dhe burrave që kanë kohë çdo ditë ose disa herë në javë për aktivitete sportive, kulturore ose rekreative. Treguesi i dytë mat dallimet midis grave dhe burrave në mundësinë për të ndarë kohë për bamirësi dhe aktivitete vullnetare të paktën një herë në muaj.

### 6.1. Statusi dhe ndryshimet

**Grafiku 15: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Kohës, Maqedonia e Veriut 2015, nuk ka ndryshime për shkak të mungesës së të dhënave**



Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Kohës arrin në 55.8 pikë dhe ky është rezultati më i ulët në krahasim me fushat e tjera (së bashku me fushën Pushteti që ka pikën e dytë më të ulët). Ndryshimet në këtë fushë nuk mund të monitorohen në krahasim me Indeksin e fundit të publikuar, sepse nuk ka të dhëna të reja për treguesit e përdorur për përlogaritjen e fushës dhe nënfushave dhe shfrytëzohen të njëjtat të dhëna më të fundit nga Sondazhi Evropian për Cilësinë e Jetës (EQLS, 2016) dhe Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës (EWCS, 2015). Ky është rasti si në nivel të BE-së (EIGE, 2021), ashtu edhe në vendet e rajonit (Shqipëria, Serbia

dhe Mali i Zi) të cilat përdorin gjithashtu të dhënat e tyre më të fundit të disponueshme nga viti 2015 dhe 2016 për përllogaritjen e Indeksit në fushën e Kohës.

Rezultatet e Indeksit në nënfushat tregojnë pabarazi jashtëzakonisht të larta gjinore edhe për sa i përket kohës së shpenzuar në aktivitetet e kujdesit (55.6 pikë në Indeks) dhe aktiviteteve që lidhen me vullnetarizmin, sportin dhe rekreacionin (55.2 pikë). Në fakt, treguesit në aktivitetet e nënfushës së Aktiviteteve të kujdesit tregojnë se gratë shpenzojnë dukshëm më shumë kohë duke u kujdesur për fëmijët, nipërit ose personat e tjerë që kanë nevojë për mbështetje në familje. Pabarazia është veçanërisht e theksuar në punën e papaguar në shtëpi dhe tregon se një përqindje jashtëzakonisht e vogël e burrave (10.4 për qind) u kushtojnë kohë aktiviteteve shtëpiake nga të cilat varet jeta e përditshme dhe funksionimi i njerëzve, si gatimi, pastrimi, larja dhe aktivitete të ngjashme në shtëpi. Ndaj, gratë janë ato që kryejnë shumicën e punëve të papaguara në shtëpi, të cilat janë të përfshira në kryerjen e shumicës së detyrave që kanë të bëjnë me gatimin, pastrimin, larjen etj. (tabela 13).

**Tabela 13: Tregues në nënfushën Aktivitetet e kujdesit**

Personat e përfshirë çdo ditë në kujdesin ose edukimin e papaguar të fëmijëve ose nipërve, kujdesin për të rriturit ose personat me aftësi të kufizuara (% , popullata 18+)		
Viti	Gra	Burra
2016	39,3	29,9
Personat e përfshirë çdo ditë në aktivitete shtëpiake të papaguara, si gatim, larje, pastrim etj, (% , popullsia 18+)		
Viti	Gra	Burra
2016	71,1	10,4

Si rrjedhojë e pabarazive të mëdha gjinore në aktivitetet e nënfushës Aktiviteteve të kujdesit, pritet që treguesit në nënfushën Aktivitete sociale të tregojnë pabarazi gjinore në kohën e kaluar në aktivitete bamirësie dhe aktivitete kulturore, sportive apo aktivitete të tjera rekreative jashtë shtëpisë. (tabela 14). Treguesit në nënfushën në fjalë tregojnë se më pak gra të punësuar (13.3 për qind) krahasuar me burrat e punësuar (16.4 për qind) kanë kohë për aktivitete sportive, kulturore ose të tjera rekreative. Dallimi është edhe më i theksuar në kohën e kaluar në aktivitet vullnetar ose bamirës, respektivisht meshkujt e punësuar u kushtojnë më shumë kohë aktiviteteve vullnetare apo bamirëse krahasuar me femrat e punësuar (përkatesisht 22,9 për qind kundrejt 16,6 për qind).


**Tabela 14: Tregues në nënfushën Aktivitetet sociale**

Persona të punësuar që kanë kohë për aktivitete sportive, kulturore ose argëtuese jashtë shtëpisë së tyre, të paktën çdo ditë ose disa herë në javë (% , punonjës 15+)		
Viti	Gra	Burra
2015	13,3	16,4
Persona të punësuar që kanë kohë për veprimtari vullnetare ose bamirëse, të paktën një herë në muaj (% , punonjës 15+)		
Viti	Gra	Burra
2015	16,6	22,9

Treguesit në të dyja nënfushat konfirmojnë se normat tradicionale gjinore në lidhje me rolet gjinore të grave dhe burrave mbizotërojnë në vend, kështu që gratë, ndryshe nga burrat, vazhdojnë të bëjnë pjesën më të madhe të punës së papaguar në shtëpi lidhur me kujdesin dhe aktivitetet shtëpiake, duke e kufizuar kohën për punë me pagesë (dhe zhvillim të karrierës) dhe/ose aktivitete bamirësie, rekreative dhe pushimi.

## 6.2. Changes compared to the EU (2015)

**Grafiku 16: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Kohës, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2015**




Krahasuar me Indeksin e Barazisë Gjinore në fushën e Kohës në nivel të BE-së, vendi mbetet pas mesatares (BE-27) me 9.1 pikë, duke u renditur ndër dhjetë Shtetet Anëtare me pabarazitë gjinore më të larta në këtë fushë. Dallimi është veçanërisht i theksuar në aktivitetet e nënfushës Aktivitetet e kujdesit, ku diferenca me mesataren e BE-së është 12.3 pikë, dhe të vetmet shtete anëtare të BE-së që kanë një vlerë më të ulët në këtë nënfushë janë Bullgaria (55.7 pikë), Kroacia (54.4 pikë) dhe Greqia. (50.9 pikë).

Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së, vendi renditet i tetëmbëdhjeti, midis Republikës Çeke dhe Hungarisë (grafi-

ku 17). Mbetet prapa me 34.3 pikë pas Suedisë si vendi i renditur më lartë dhe ka një avantazh prej 13.1 pikësh përpara Bullgarisë si vendi më i ulët në këtë fushë brenda BE-së.

Krahasuar me vendet e rajonit dhe matjen e tyre të fundit të Indeksit, në këtë fushë Maqedonia e Veriut renditet më mirë se Shqipëria (plus 7,7 pikë), Serbia (plus 7,1 pikë) dhe Mali i Zi (plus 3,1 pikë). Ka rezultate më të larta në nënfushat krahasuar me të tre vendet, me përjashtim të Malit të Zi, ku vetëm rezultati i nënfushës Aktivitetet sociale (56.2 pikë) është më i lartë se ai i Maqedonisë së Veriut.

**Grafiku 17: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Kohës, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)<sup>7</sup>**



Të dhënat e disponueshme për përdorimin e kohës tregojnë se gratë shpenzojnë dukshëm më shumë kohë në punë të papaguar shtëpiake dhe kujdesin e fëmijëve në krahasim me burrat, pavarësisht nga statusi i tyre i punësimit, mosha, statusi martesor/i partneritetit, statusi prindëror ose vendbanimi (mjedis urban/rural) (ESHS, 2015). Raporti i fundit mbi ndikimin e COVID-19 zbuloi se konteksti i pandemisë ka përkeqësuar më tej pabarazitë gjinore në ndarjen e punës së papaguar dhe kujdesin ndaj fëmijëve (UN Women, 2020).

Gratë në vend e shtuan ndjeshëm kohën e kushtuar kujdesit ndaj fëmijëve dhe aktiviteteve shtëpiake, si gatimi, larja, pastrimi etj., veçanërisht nënat dhe gratë që jetojnë me bashkëshortët/partnerët. Burrat e kanë rritur kohën e shpenzuar në aktivitetet shtëpiake, veçanërisht kohën e kushtuar kujdesit ndaj fëmijëve në krahasim me periudhën para fillimit të pandemisë. Megjithatë, ndryshimet te burrat janë më pak të theksuara në krahasim me rritjen e kohës së kushtuar këtyre aktiviteteve tek gratë (UN Women, 2020).

Pabarazia e shprehur gjinore në ndarjen e punës së papaguar e kufizon kohën dhe mundësinë e disponueshme për gratë për të bërë punë me pagesë (shih fushën e Punës) dhe për të arritur sigurinë financiare dhe pavarësinë ekonomike, e kufizon mundësinë e grave për të marrë pjesë në jetën publike, e kufizon kohën e tyre për pushim dhe për aktivitete të tjera shoqërore dhe vullnetare. Politikat që kontribuojnë në barazi më të madhe në shpërndarjen e punëve të papaguara të shtëpisë dhe kujdesit ndaj fëmijëve përfshijnë edukimin e hershëm të fëmijërisë me ndjeshmëri gjinore, një rritje të vazhdueshme të investimeve publike në kopshte të reja dhe shërbime të kujdesit për të rriturit dhe një politikë të përbashkët të pushimit prindëror që, përveç pushimit të lehonisë, gjithashtu përfshin edhe lejen e detyrueshme të babait.

<sup>7</sup> BE-ja dhe Shtetet e rajonit (Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi), po ashtu, i shfrytëzojnë të dhënat e fundit të disponueshme nga viti 2015 dhe 2016 për përlogaritjen e Indeksit në fushën e Kohës.

# 7. Fusha e Pushtetit



Fusha e Pushtetit i mat pabarazitë gjinore në pjesëmarrjen në strukturat e pushtetit politik, ekonomik dhe social. Shpërndarja e pabarabartë e pushtetit midis grave dhe burrave ndikon në barrierat sistemike, diskriminimin dhe pabarazitë gjinore në të gjitha sferat sociale. Indeksi i barazisë gjinore në fushën e Pushtetit matet përmes tre nënfushave: pushteti politik, ekonomik dhe ai social që i pasqyrojnë marrëdhëniet e pushtetit në fushat kyçe të sferës publike.


Nënfusha e Pushtetit politik matet nëpërmjet treguesve për përfaqësimin e grave dhe burrave në postet ministrore si anëtarë të Qeverisë (pushtetit ekzekutiv), përfaqësimin të tyre në Parlament (pushtetit legjislativ), si dhe pjesëmarrjes së tyre në pushtetin vendor (kryetarë/kryetare komunash dhe këshilltarë/këshilltare në Këshillat lokalë). Strukturat e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe të qeverisjes vendore janë fusha të pushtetit politik (të lidhura edhe me shpërndarjen e burimeve ekonomike), ku krijohen dhe merren vendime politike që ndikojnë në jetën e përditshme të të gjithë njerëzve në vend në çdo sferë të jetës.

Nënfusha Fuqia ekonomike mat pabarazitë gjinore në menaxhimin e burimeve ekonomike nëpërmjet treguesve të përfaqësimin të grave dhe burrave në pozicione drejtuese në kompanitë të listuara lartë në vend dhe në strukturën drejtuese të Bankës Qendrore (Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonia e Veriut).

Nënfusha e tretë, Pushteti social, mat pabarazitë nëpërmjet treguesve të përfaqësimin në organet drejtuese të institucioneve financuese të kërkimit, organizatave kombëtare riodifuzive dhe organizatave kombëtare sportive olimpikë.

## 7.1. Statusi dhe ndryshimet

**Grafiku 18: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Pushtetit, Maqedonia e Veriut 2015 - 2019**



Fusha e Pushtetit shënon rritjen më të madhe të rezultatit në krahasim me vitin 2015. Rezultati i përmbledhur i kësaj fushe është rritur me 6 pikë dhe kjo rritje vjen si pasojë e rritjes së rezultateve të Indeksit në të gjitha nënfushat (grafiku 18). Megjithatë, përveç progresit në këtë fushë, pas fushës së Kohës, Pushteti është fusha e dytë në të cilën vendi shënon rezultatet më të ulëta, respektivisht pabarazinë më të lartë gjinore. Nga ana tjetër, në nivelin e BE-së (BE-27), pabarazia më e madhe gjinore vërehet pikërisht në fushën e Pushtetit.

Rritja më e madhe e rezultatit është në nënfushën Pushteti politik (+6,7 pikë), e ndjekur nga Pushteti ekonomik me një rritje prej 6,5 pikësh krahasuar me vitin 2015 dhe nënfusha Pushteti social ku ka progres prej 4 pikësh krahasuar me matjen e mëparshme. Rritja e Indeksit në fushën dhe nënfushat e Pushtetit është rezultat i përmirësimit të pothuajse të gjithë treguesve të pushtetit politik, ekonomik dhe social. Por, krahasuar me vitin 2015, ka një rënie të treguesit të pjesëmarrjes së grave në Bordet Drejtuese, Bordet Mbikëqyrëse apo Bordet e Drejtorëve të kompanive më të listuara në bursë.

Vlerat e Indeksit në këtë fushë janë përlogaritur duke përdorur të dhënat nga baza e të dhënave statistikave gjinore të Institutit Evropian për Barazi Gjinore – Gratë dhe Burrat në Procesin e Vendimmarrjes (EIGE, 2022). Rritja e vlerës së Indeksit në nënfushën Pushteti politik është rezultat i një rritje të caktuar të pjesëmarrjes së grave në pushtetin ekzekutiv (pozicione ministore në Qeveri), në Kuvend, si dhe në pushtetin vendor në krahasim me vitin 2015 (tabela 15). Hendek më të vogël gjinor ka në treguesin e pjesëmarrjes së grave në Parlament, respektivisht aty ku ka një kuotë të përcaktuar ligjore për pjesëmarrje. Hendeku më i madh, nga ana tjetër, është në pushtetin ekzekutiv, respektivisht në pozitat ministore, ku gratë janë të përfaqësuara në numër shumë të vogël (tabela 15).

Me matjen paraprake konfirmohet se mungesa e kuotave për pjesëmarrje në të gjitha strukturat qeveritare ndikon në pjesëmarrjen drastike të ulët të grave në pushtetin ekzekutiv dhe lokal dhe në shpërndarjen joproporcionale të pushtetit politik në favor të burrave. Ndonëse ka rritje të caktuar të përfaqësimit të grave në nivele të ndryshme të qeverisjes, ende nuk është e mjaftueshme dhe nuk është në përputhje me "Angazhimin strategjik 50-50" për pjesëmarrje të barabartë politike të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e qeverisjes politike (Strategjia për Barazi Gjinore 2022 - 2027, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 170/2022). Prandaj, pabarazitë

gjinore mbeten jashtëzakonisht të larta dhe tregojnë nevojën për një angazhim serioz për tejkalimin e pabarazisë në përfaqësim në strukturat ekzekutive, legjislative dhe të pushtetit vendor dhe ndikimin e përgjithshëm të grave në jetën politike.

**Tabela 15: Tregues në nënfushën Pushteti politik**

Pjesëmarrja në pozicionet ministore (%)		
Viti	Gra	Burra
2014-2015-2016 (mesatarja)	11,5	88,5
2018-2019-2020 (mesatarja)	14,7	85,3
Pjesëmarrja në Parlament (%)		
Viti	Gra	Burra
2014-2015-2016 (mesatarja)	34,8	65,2
2018-2019-2020 (mesatarja)	38,3	61,7
Pjesëmarrja në pushtetin lokal (%)		
Viti	Gra	Burra
2014-2015-2016 (mesatarja)	28,8	71,2
2018-2020 (mesatarja)	32,4	67,6

Në nënfushën Pushteti ekonomik, treguesit tregojnë një rënie të pjesëmarrjes së grave në organet drejtuese dhe bordet e kompanive të listuara lartë në vend në krahasim me vitin 2015, por edhe rritje të pjesëmarrjes së grave në organet drejtuese të Bankës Popullore (Banka Qendrore) (tabela 16). Rënia e pjesëmarrjes së grave në organet dhe bordet drejtuese është një trend shqetësues. Ky trend negativ nuk është në përputhje jo vetëm me qëllimet dhe angazhimet strategjike kombëtare në këtë fushë (Strategjia për Barazinë Gjinore 2022 - 2027, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 170/2022), por edhe me agjendën e BE-së për barazinë gjinore, e cila është e rëndësishme për Maqedoninë e Veriut si shtet kandidat për anëtarësim në Union. Në fakt, Direktiva e BE-së e miratuar së fundmi 2022/2381<sup>8</sup> për përmirësimin e barazisë gjinore në strukturat drejtuese të kompanive të listuara lartë në bursa përcakton një kuotë minimale prej 40% të përfaqësimit të pozicioneve në Borda të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, 2022).

<sup>8</sup> Direktiva e BE-së 2022/2381 për përmirësimin e ekuilibrit gjinor midis drejtorëve/drejtoreshave të kompanive që janë të listuara në bursa (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, 2022)



**Tabela 16: Tregues në nënfushën Pushteti ekonomik**

Pjesëmarrja në bordet drejtuese, bordet mbikëqyrëse ose bordet e drejtorëve/drejtove në kompanitë të listuara lartë (%)		
Viti	Gra	Burra
2014-2015-2016 (mesatarja)	20,5	79,5
2018-2019-2020 (mesatarja)	19,1	80,9
Pjesëmarrja në organet drejtuese të bankave qendrore (%)		
Viti	Gra	Burra
2014-2015-2016 (mesatarja)	24,0	76,0
2018-2019-2020 (mesatarja)	32,0	68,0


Treguesit në nënfushën Pushteti social tregojnë një ndryshim të vogël në pjesëmarrjen e grave në organet drejtuese të institucioneve të financimit të kërkimit shkencor, në organizatat sportive olimpike ka një ndryshim të parëndësishëm, ndërsa në treguesin e pjesëmarrjes në organet drejtuese të organizatave kombëtare radiodifuzive nuk ka asnjë ndryshim me matjen e fundit (tabela 17). Kjo është nënfusha ku shënohet progresi më i vogël krahasuar me vitin 2015 dhe nevojitet një përmirësim i ndjeshëm i pabarazisë në përfaqësim në organet drejtuese, veçanërisht në institucionet që lidhen me sektorin e sportit, ku ka dallime më të larta gjinore, respektivisht përfaqësim i ulët i grave.

**Tabela 17: Tregues në nënfushën Pushteti social**

Pjesëmarrja në organet drejtuese të institucioneve të financimit të kërkimit shkencor (%)		
Viti	Gra	Burra
2016	42,9	57,1
2019	51,9	48,1
Pjesëmarrja në organet drejtuese të organizatave kombëtare radiodifuzive (%)		
Viti	Gra	Burra
2015-2016-2017 (mesatarja)	46,2	53,8
2018-2019-2020 (mesatarja)	46,2	53,8
Pjesëmarrja në organet drejtuese të organizatave kombëtare sportive olimpike (%)		
Viti	Gra	Burra
2015	8,9	91,1
2018-2019-2020 (mesatarja)	9,2	90,8

## 7.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)

**Grafiku 19: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Pushtetit, Maqedonia e Veriut dhe BE, 2019**




Ashtu sikurse në matjen paraprake të Indeksit (viti 2019), vendi shënon sërish rezultate më të mira në fushën e Pushtetit në krahasim me mesataren e BE-së. Rezultati i vendit në fushën e Pushtetit është 3.6 pikë më i lartë krahasuar me mesataren e Shteteve Anëtare të BE-së. Vendi shënon rezultate më të larta se mesatarja e BE-së në nënfushën Pushtetit ekonomik (+2,3 pikë) dhe veçanërisht në nënfushën Pushteti social (+11 pikë), por mbetet prapa në nënfushën Pushteti politik (-1,7 pikë). (Grafiku 19).

Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së, Maqedonia e Veriut është në vendin e dhjetë, mbi mesataren e BE-së dhe pak më poshtë Bullgarisë dhe Irlandës (grafiku 20). Vendi më mirë i renditur brenda BE-së është sërish Suedia, pas së cilës Maqedonia e Veriut mbetet prapa 25.9 pikë, ndërsa vendi më i ulët me pabarazitë gjinore më të larta në këtë fushë është Hungaria, me 35.7 pikë nën rezultatin përmbledhës të Maqedonisë së Veriut.

Kjo është e vetmja fushë ku vendi e tejkalon mesataren evropiane, por rezultatet më të mira nuk tregojnë pabarazi më të ulëta gjinore në këtë fushë, por pabarazi gjinore jashtëzakonisht të larta në fushën e Pushtetit në shumicën e Shteteve Anëtare të BE-së, ku burrat, sikurse në nivel botëror, dominojnë në strukturat dhe pozitat më të larta vendimmarrëse të pushtetit.

**Grafiku 20: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Pushtetit, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)**




Krahasuar me vendet e rajonit, Maqedonia e Veriut ka rezultate më të larta në këtë fushë se Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi (grafiku 20). Ndonëse matjet e Indeksit me vendet e rajonit nuk u referohen të njëjtave vite, megjithatë ato ende janë treguesdhe në një periudhë kohore relativisht të fundit, gjë që jep mundësi për të krahasuar situatën me pabarazitë gjinore në këtë fushë me vendet fqinje. Shqipëria ka vlera më të larta në nënfushat Pushteti politik (71,7 pikë kundrejt 56,8 pikë) dhe Pushteti ekonomik (74,5 pikë kundrejt 51,1

pikë), ndërsa në fushën Pushteti social ka rezultat më të ulët (42,3 pikë kundrejt 69, 2 pikë). Krahasuar me Serbinë, Maqedonia e Veriut ka rezultate më të mira në nënfushat e Pushtetit ekonomik (51.1 pikë Maqedonia e Veriut; 43 pikë Serbia) dhe Pushteti social (69.2 pikë Maqedonia e Veriut; 38.5 pikë Serbia), ndërsa rezultati për Pushtetin politik tregon pabarazi më të ulëta gjinore në Serbi (56.8 pikë Maqedonia e Veriut; 60.7 pikë Serbia).



## 8. Fusha e Shëndetit



Fusha e Shëndetit mat pabarazitë gjinore në aksesin në shërbimet shëndetësore, dallimet në sjelljet shëndetësore, jetëgjatësinë, si dhe perceptimet individuale të gjendjes shëndetësore. Kjo fushë përbëhet nga tre nënfusha: Statusi shëndetësor, Sjellje të shëndetshme dhe Aksesi në Shërbimet e kujdesit shëndetësor.


Nënfusha e parë matet përmes treguesve të perceptimeve personale të gjendjes shëndetësore, jetëgjatësisë, si dhe viteve të pritshme të jetës në shëndet të mirë.

Nënfusha e dytë monitorohet nëpërmjet treguesit të shprehive të pirjes së duhanit dhe konsumimit të alkoolit, si dhe treguesit të praktikimit të aktivitetit fizik dhe të ushqyerit të shëndetshëm.

Nënfusha e fundit mat aksesin në kujdesin shëndetësor për gratë dhe burrat nëpërmjet treguesve të nevojave të përmbushura për ekzaminim mjekësor dhe dentar, diagnostikim dhe terapi. Është e rëndësishme të theksohet se matja bazohet në tregues të përgjithshëm që nuk hyjnë në nevojat specifike për shërbime të ndryshme shëndetësore të grave dhe burrave.

### 8.1. Statusi dhe ndryshimet

**Grafiku 21: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e Shëndetit, Maqedonia e Veriut 2015 – 2019**



Fusha e Shëndetit nuk ka ndryshime të rëndësishme në krahasim me vitin 2015, duke pasur parasysh faktin se ka një rritje të rezultatit të Indeksit me minimum 0.1 pikë. Përveç rritjes minimale në nënfushën e Aksesit (0,7 pikë), kontributi në rezultatin pothuajse të stagnuar në fushë është ulja e rezultatit të nënfushës Statusi (-0,3 pikë) dhe mungesa e të dhënave të reja në nënfushën Sjelljet (të dhënat janë të njëjta me matjen e mëparshme nga viti 2015) (grafiku 21).

Në nënfushën Status ka ndryshime negative në dy tregues krahasuar me vitin 2015, në perceptimet individuale për gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe vlerësimin e viteve të pritshme të jetës së shëndetshme për gratë dhe burrat (tabela 18). Një përqindje më e vogël e grave e vlerësojnë gjendjen e tyre të përgjithshme shëndetësore si të mirë ose shumë të mirë krahasuar me burrat dhe, kjo diferencë është rritur në vitin 2019 (tabela 18). Në vlerësimin e viteve të pritshme të jetës së shëndetshme vërehet një përqendrim i treguesit për femrat, ndërsa për meshkujt ka një rritje të caktuar krahasuar me vitin 2015 dhe kjo, nga ana tjetër, ndikon në uljen e hendekut gjinor në vitin 2019 në favor të burrave. Treguesi që mat jetëgjatësinë tregon një rritje si për gratë ashtu edhe për burrat në krahasim me vitin 2015 (përafërsisht një vit), por, si në nivel global, jetëgjatësia për gratë është më e lartë. Krahasuar me vendet e BE-së dhe rajonit, Maqedonia e Veriut ka një nga vlerat më të ulëta të jetëgjatësisë dhe është afër vendeve të rajonit (Serbisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi), si dhe shteteve anëtare të BE-së - Bullgarisë, Rumanisë dhe Hungarisë.

**Tabela 18: Tregues në nënfushën Statusi**

Perceptimi personal i gjendjes së përgjithshme të shëndetit; mirë ose shumë mirë (% , popullata 16+)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	74,4	79,8	-5,4
2019	71,7	77,6	-5,9
Jetëgjatësia e pritur (në vite)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor
2014	77,4	73,5	3,9
2019	78,6	74,7	3,9
Vite të pritshme të jetës së shëndetshme (në vite)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor
2015	66,5	65,4	1,1
2019	65,4	65,8	-0,4

Në nënfushën e dytë nuk ka përditësim të të dhënave nga matja e fundit për vitin 2015 dhe nuk mund të monitorohen ndryshimet në treguesit e shprehive të pirjes së duhanit dhe konsumimit të alkoolit, të ushqyerit të shëndetshëm dhe aktivitetit fizik. Të dhënat nga matjet e fundit tregojnë se gratë, mesatarisht, kanë shprehuri më të mira shëndetësore në krahasim me burrat, gjegjësisht ka më pak gra që pinë cigare dhe konsumojnë tepër alkool, si dhe kanë shprehuri më të mira për sa i përket aktivitetit fizik dhe ushqimit (tabela 19).

**Tabela 19: Tregues në nënfushën Shprehitë**

Persona që nuk pinë duhan dhe nuk konsumojnë alkool tepër (% , popullata 16+)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2014	73,4	36,2	37,2
Persona që janë fizikisht aktivë për të paktën 150 minuta në javë dhe/ose në ditë konsumojnë pesë porcione frutash dhe perimesh (% , popullata 16+)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2014	63,4	53,3	10,1


Nënfusha e fundit që mat pabarazitë gjinore në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve tregon se ka një përmirësim për gratë në aksesin ndaj ekzaminimeve dhe trajtimit mjekësor në krahasim me vitin 2015 dhe një reduktim të dallimit në aksesin ndaj shërbimeve mjekësore. Për sa i përket aksesit në ekzaminimet dentare, tek femrat nuk ka ndryshime dhe mbetet diferenca e vogël në krahasim me meshkujt. Në këtë nënfushë rezultatet tregojnë pabarazitë gjinore më të ulëta krahasuar me fushat dhe nënfushat e tjera të Indeksit.

**Tabela 20: Tregues në nënfushën Shprehitë**

Persona pa nevojë të paplotësuar për ekzaminim ose trajtim mjekësor (% , popullata)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	93,1	94,7	-1,6
2019	95,1	95,1	0
Persona pa nevojë të paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar (% , popullata)			
Viti	Gra	Burra	Hendeku gjinor (pikë-përqindjeje)
2015	96	95,7	0,3
2019	96	95,6	0,4

## 8.2. Ndryshimet krahasuar me BE (2019)


**Grafiku 22: Gender Equality Index in the domain of Health and its sub-domains, North Macedonia and EU, 2019**



Rezultati i përmbljedhës i fushës së Shëndetit është për 0.6 pikë më i ulët se mesatarja e BE-së. Dallimi më i madh është në nënfushën e Shprehive, ku vendi mbetet pas mesatares së BE-së me 2 pikë, por arrin një rezultat më të mirë krahasuar me mesataren e BE-së në nënfushën e Statusit (0,9 pikë më shumë) (grafiku 22).

Krahasuar me rezultatet e Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut renditet e pesëmbëdhjeta, pak pas Francës dhe mbi Malin e Zi dhe Hungarinë (grafiku 23). Vendi shënon rezultat më të lartë në fushën e Shëndetit krahasuar me matjen e fundit të vendeve të rajonit, më të lartë me 0.3 pikë se Mali i Zi, 3.1 pikë mbi Serbinë dhe 5.4 pikë mbi rezultatin përmbljedhës në fushën në fjalë krahasuar me Shqipërinë.


**Grafiku 23: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e Shëndetit, Maqedonia e Veriut (2019), Shtetet Anëtare të BE (2019), Shqipëria (2017), Serbia (2018) dhe Mali i Zi (2017)**



Ndonëse kjo është fusha e dytë me diferencat më të vogla në krahasim me mesataren e BE-së (pas fushës së Dijëve), vendi ende mbetet prapa mesatares së BE-së dhe është 7.4 pikë prapa vendit të renditur më mirë në fushën në fjalë - Suedisë. Nevojiten përmirësime të pabarazive gjinore, veçanërisht në nënfushën Shprehite shëndetësore dhe Statusi shëndetësor, ndërsa në nënfushën e Shprehive nevojiten matje të reja dhe të dhëna të reja për monitorim gjithëpërfshirës dhe të rregullt të ndryshimeve. Është e rëndësishme të theksohet se kjo fushë nuk mund të përfshijë plotësisht të gjitha pabarazitë relevante shëndetësore, veçanërisht ato që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe shërbimet specifike shëndetësore të nevojshme për gratë. Në veçanti, ka një mungesë

të njohurive për aksesin dhe nevojat e paplotësuara për kujdes mjekësor për grupet e cenueshme dhe të marginalizuara të njerëzve që shpesh përballen me diskriminim të ndërlidhur në aksesin në shërbimet shëndetësore. Prandaj është e rëndësishme të theksohen rastet ekzistuese të njohura të diskriminimit interseksional, siç janë rastet e diskriminimit në aksesin në shërbimet gjinekologjike për gratë romë në vend (CEDAW, 2020), si dhe gjetjet e fundit që tregojnë një nivel dukshëm më të lartë të nevojave të paplotësuara për ekzaminimet mjekësore të romët, të cilët i nënvizojnë kostot e larta financiare dhe mungesën e sigurimit shëndetësor si pjesë e arsyeve kryesore për aksesin e kufizuar në shërbimet shëndetësore (Robayo-Abril dhe Millan, 2019).

# 9. Fusha e Dhunës



Fusha e Dhunës është fusha e dytë shoqëruese (satelitore). Kjo fushë bazohet konceptualisht në dhunën me bazë gjinore ndaj grave, si dhe në ndikimin e qëndrimeve, normave dhe stereotipave në shoqëri lidhur me dhunën dhe barazinë. E mat dhunën ndaj grave, kryesisht për faktin se gratë janë viktimat më të shumta të dhunës me bazë gjinore në nivel global dhe në shumicën e rasteve ajo ushtrohet nga burrat. Kjo fushë matet përmes nënfushave përbërëse Përhapja e dhunës, Ashpërsia (shkalla e pasojave shëndetësore dhe jetësore për viktimën e dhunës) dhe Denoncimi i dhunës në institucione dhe/ose te persona të tjerë (EIGE, 2017c). Metodologjia për përlogaritjen e fushës së dhunës të EIGE është zhvilluar bazuar në metodologjinë e anketës së Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) mbi dhunën ndaj grave (FRA, 2014).

Kjo fushë është konceptualisht e ndryshme nga fushat e tjera sepse nuk i mat dallimet gjinore, por shkallën e dhunës ndaj grave. Prandaj, qëllimi përfundimtar nuk është zvogëlimi i pabarazive gjinore, por çrrënjësja e dhunës. Si një fushë mbështetëse, nuk përfshihet në përlogaritjen e vlerës së Indeksit të Barazisë Gjinore.

## 9.1. Statusi

Maqedonia e Veriut ende nuk ka të dhëna të disponueshme që mund të përdoren për përlogaritjen e treguesit të përbërë për fushën e Dhunës, megjithëse është e rëndësishme të theksohet se në periudhën e kaluar Enti Shtetëror i Statistikës bëri një hap të rëndësishëm në këtë drejtim. Në periudhën gusht - shtator 2022, Enti Shtetëror i Statistikës ka realizuar anketën e parë kombëtare mbi dhunën me bazë gjinore duke përdorur metodologjinë e Eurostat-it, me mbështetje financiare nga fondet IPA (instrument i Bashkimit Evropian për Ndihmë Paraderimit). Anketa do të realizohet çdo pesë vjet dhe është pjesë e Programit aktual të Kërkimeve Statistike 2023 - 2027 të Entit Shtetëror të Statistikës. Anketa kombëtare e radhës për dhunën me bazë gjinore është planifikuar për vitin 2027. Instituti Evropian për Barazi Gjinore do të përdorë të dhënat nga Anketa e Dhunës me Bazë Gjinore në mbarë BE-në për të përlogaritur fushën e Dhunës dhe për të vlerësuar përhapjen e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe vajzave në shtetet anëtare të BE-së. Llogaritja e fushës së Dhunës duke zbatuar metodologjinë e EIGE do të mundësohet edhe në Maqedoninë e Veriut duke përdorur të dhënat kombëtare krahasuese për vendin që do të rezultojnë nga anketa për dhunën me bazë gjinore të kryer nga ESHS-ja.

Në mungesë të të dhënave të disponueshme në nivel kombëtar, ky raport përmbledh një pjesë të rezultateve të hulumtimit mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut të kryer nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim

në Evropë (OSBE) në vitin 2019 (OSBE, 2019). Të dhënat e paraqitura, mbi të gjitha, i referohen përhapjes së dhunës ndaj grave në vend dhe përkohë me treguesit në nënfushën Përhapja (tabela 21).

**Tabela 21: Përhapja e dhunës ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, viti 2019 (%)**

Dhunë të pësuar psikologjike, fizike dhe/ose seksuale nga cilido autor (partner intim ose jo)	prej moshës 15 vjeçare	44%
Dhuna e pësuar fizike dhe/ose seksuale e kryer nga cilido autor (partner intim ose jo)	prej moshës 15 vjeçare	14%
	në 12 muajt e fundit	4%
Dhuna e shkaktuar nga autor që nuk është partner intim	prej moshës 15 vjeçare	Fizike: 6%
		Seksuale: 2%
	në 12 muajt e fundit	Fizike: 2%
		Seksuale: 0.1%
Dhuna e shkaktuar nga partneri intim (aktual ose ish)	prej moshës 15 vjeçare	Fizike: 9%
		Seksuale: 3%
		Psikologjike: 44%
	në 12 muajt e fundit	Fizike: 3%
		Seksuale: 1%
		Psikologjike: 12%
Ngacmimi seksual	prej moshës 15 vjeçare	30%
	në 12 muajt e fundit	10%
Ndjekja/përndjekja	prej moshës 15 vjeçare	7%
	në 12 muajt e fundit	2%
Ndonjë formë e shkaktuar e dhunës së bazuar në gjini	prej moshës 15 vjeçare	54%
	në 12 muajt e fundit	20%
Abuzimi në fëmijëri (fizike, seksuale, psikologjike)	para moshës 15 vjeçare	Fizike: 7%
		Seksuale: 1%
		Psikologjike: 3%

Burimi: OSCE, 2019

Hulumtimi mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Maqedoninë e Veriut tregon se dhuna ndaj grave është shumë e përhapur dhe më shumë se gjysma e grave (54 për qind) kanë pësuar një formë dhune që nga moshën 15 vjeçare (OSBE, 2019). Pothuajse gjysma e grave (44 për qind) ishin viktimat të dhunës psikologjike, fizike dhe/ose seksuale që nga moshën 15 vjeçare, ndërsa 14 për qind ishin viktimat të dhunës fizike dhe/ose seksuale. Situata në nivel të BE-së (BE-28) tregon një përhapje më të lartë të dhunës fizike dhe seksuale, respektivisht 33 për qind e grave kanë pësuar këtë lloj dhune me bazë gjinore që në moshën 15-vjeçare.

Por, është jashtëzakonisht e rëndësishme të theksohet se, në krahasim me BE-në, dallimet duhet të lexohen përmes kontekstit social në vend kundrejt vendeve të BE-së. Në fakt, në vendet ku ka praktika dhe politika afatgjata për avancimin e barazisë gjinore, informimi i gjerë dhe një sistem funksional për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave (Shtetet skandinave dhe shumica e vendeve të Evropës Perëndimore), ka edhe një shkallë më të madhe të njohjes dhe denoncimit të dhunës (OSBE, 2019). Prandaj, nivelet e denoncimit dhe regjistrimit të dhunës janë shpesh më të larta në këto vende në krahasim

me mjediset ku dhuna ndaj grave shpesh konsiderohet një çështje private që duhet të mbetet brenda shtëpisë, ku stigma për gratë viktime të dhunës është e lartë, ka një nivel të lartë normalizimit të dhunës dhe ka mekanizma të dobët institucionalë për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave, siç është rasti në Maqedoninë e Veriut (OSBE, 2019).

Gjithashtu, hulumtimi tregon se rreziku i dhunës për gratë vjen më së shumti nga partneri intim dhe madje 44 për qind e grave kanë pësuar dhunë psikologjike, 9 për qind kanë vuajtur dhunë fizike, ndërsa 3 për qind kanë vuajtur dhunë seksuale nga partneri intim që në moshën 15 vjeçare. vjeç (tabela 21). Dhuna fizike dhe seksuale nga një partner intim është veçanërisht e përhapur në mesin e grave që jetojnë në familje me vështirësi ekonomike dhe financiare (OSBE, 2019).

Një nga format e shpeshta të dhunës në vend është ngacmimi seksual. Një për qindje e lartë (30 për qind) e grave në vend kanë pësuar ngacmime seksuale që në moshën 15 vjeçare dhe 10 për qind në 12 muajt e fundit gjatë periudhës së anketimit (tabela 21). Gratë më të reja dhe më të arsimuara që jetojnë në zonat urbane, mesatarisht, kanë raportuar më shumë si janë ekspozuar ngacmimit seksual, dhe kjo, nga ana tjetër, tregon njëkohësisht ndërgjegjësim dhe njohje më të madhe të dhunës në mesin e këtyre grupeve të grave (OSBE, 2019).

Gjetjet e hulumtimit tregojnë për një përfaqësim të lartë të normave tradicionale gjinore në shoqëri, respektivisht të kuptuarit e rolit të gruas në shoqëri dhe në shtëpi. Një për qindje e lartë e grave (37 për qind) vlerësojnë se mjedisi i tyre i ngushtë e miraton nënshtrimin e një gruaje ndaj burrit të saj (përfshirë edhe nënshtrimin e detyruar), 32 për qind e grave besojnë se është e rëndësishme që një burrë të tregojë dominimin e tij ndaj gruas së tij, ndërsa 30 për qind e grave besojnë se viktimat e dhunës trillojnë ose ekzagjerojnë gjetjet e dhunës dhe përdhunimit (OSBE, 2019). Pikërisht ky kontekst social, në të cilin ka ende një shkallë të lartë të pranimit dhe normalizimit të roleve tradicionale gjinore në shoqëri, për fat të keq, përfaqëson një nga faktorët domethënës që mundëson dhe kontribuon në përhapjen dhe normalizimin e gjerë të dhunës që mbetet kryesisht e panjohur, e pa-denoncuar dhe e pa-sanksionuar plotësisht nga institucionet kompetente.

Krahas gjetjeve të hulumtimit të disponueshëm, në periudhën e kaluar ka pasur disa raste alarmante të dhunës me bazë gjinore të kryer përmes teknologjisë (dhuna kibernetike ose digjitale). Bëhet fjalë për dhunën me bazë gjinore që ndodh ose amplifikohet në mjedisin digjital dhe hapësirën online (në internet), por që vazhdon të prekë viktimat edhe në hapësirën fizike (offline) (EIGE, 2017). Një nga rastet më të famshme të fundit të ngacmimeve seksuale masive në internet, i njohur si rasti i "Dhomës publike" (kanali Telegram), u zbulua fillimisht në janar të vitit 2020. Anëtarët e grupit të "Dhomës publike" kanë shpërndarë foto dhe video eksplicite të grave, vajzave dhe vajzave të mitura pa leje, duke ndarë gjithashtu informacionet e tyre private (numrat e telefonit, adresat, profilet e mediave sociale etj.), duke rezultuar në ngacmime seksuale të grave dhe vajzave me përmasa të mëdha në hapësirën online (dhe offline) (BIRN, 2021; Global Voices, 2022). Rasti në fjalë mori shumë vëmendje të publikut në janar të vitit 2021, pas zbulimit publik të dhunës së pësuar të njëjës prej viktimave të rastit. Pas një reagimi të fortë publik nga organizatat feministe, aktiviste dhe aktorë të tjerë relevantë, nisi një hetim nga institucionet kompetente dhe disa nga të dyshuarit (krijuesit dhe administratorët e grupit) u akuzuan për prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë për fëmijë, por nuk u ngritën akuza shtesë për ngacmim seksual dhe keqpërdorim të të dhënave personale të viktimave.

Ligji i Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Dhuna ndaj Femrave dhe Dhunës në Familje (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 24/2021) dhe ndryshimet e fundit në Kodin Penal (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 36/2023) parashikojnë dispozita të veçanta për ngacmimin seksual që i përfshinë edhe format online të ngacmimit seksual dhe ndjekjes. Në periudhën në vijim është jashtëzakonisht e rëndësishme që institucionet kompetente të zbatojnë plotësisht dhe në mënyrë konsekuente legjislacionin ekzistues, me qëllim mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore, por edhe të punojnë me përkushtim në parandalimin dhe mbrojtjen e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhuna me bazë gjinore siç përcaktohet në kornizën ligjore dhe në dokumentet strategjike të fushës së vendit.

# 10. Konkluzione përmbledhëse

Indeksi i Barazisë Gjimore në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 është 64.5 pikë nga maksimumi 100 pikë dhe tregon një progres prej 2.5 pikësh krahasuar me matjen e fundit në vitin 2019. Megjithatë, është një progres i ngadalshëm që, nëse vazhdon me këtë ritëm, do të duhen rreth 57 vjet për të arritur barazinë gjimore në fushat e matjes së Indeksit.

Progres vihet re në fushën e Punës, Parasë, Dijes dhe Fuqisë, që është rezultat i rritjes së normave të punësimit për gratë, përmirësimit të aksesit në burimet financiare (rritje e të ardhurave mesatare mujore dhe rritje e të ardhurave neto mesatare ekuivalente), rritja e përqindjes së personave me arsim të lartë të përfunduar dhe përmirësimi i treguesve të pushtetit politik, ekonomik dhe social. Nuk ka ndryshime në fushën e Kohës për shkak të mungesës së të dhënave të reja (situata është e njëjtë në BE dhe në vendet e rajonit) dhe në fushën e Shëndetit ku mungojnë të dhënat e reja në nënfushën Shprehite dhe ndryshimi në rezultatin e Indeksit është i parëndësishëm (+ 0.1) pikë).

Krahasuar me matjet e fundit në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor që e publikojnë Indeks, vendi ka një rezultat më të lartë se të tre vendet - Shqipëria me 60.4 pikë (viti 2020), Serbia me 58 pikë (viti 2021) dhe Mali i Zi me 55 pikë (viti 2019). Krahasuar me BE-në, ashtu si në matjen e mëparshme, vendi është pozicionuar pas mesatares së Shteteve Anëtare të BE-së, por diferenca është ulur (4.2 pikë në vitin 2019; 3.5 pikë në vitin 2022). Matjet ekzistuese tregojnë se vendi po ecën përpara me përafërsisht të njëjtin ritëm si BE-ja, duke treguar nevojën për përmirësim të ndjeshëm në politikat, praktikën dhe angazhimin e vendit për barazinë gjimore në periudhën që vijon.

Të gjitha fushat e Indeksit tregojnë nevojën për përmirësim të konsiderueshëm, pavarësisht progresit të arritur që nga matja e fundit. Hendeku gjinor në fushën e Dijes, krahasuar me pesë fushat e tjera të Indeksit, është e vetmja fushë ku pabarazia gjimore është rezultat i gjendjes jo të favorshme të burrave në krahasim me gratë (veçanërisht e theksuar në nënfushën Arsimit të përfunduar dhe pjesëmarrja). Pabarazia gjimore në fushën e Punës tregon se gratë përballen me barriera të konsiderueshme në aksesin në tregun e punës dhe, për këtë arsye, ato kanë nivele më të ulëta aktiviteti dhe punësimi dhe, mesatarisht, kanë më shumë gjasa se burrat të punojnë si punonjëse të papaguara të familjes. Si rrjedhojë e kësaj, fusha e Parasë tregon se gratë në Maqedoninë e Veriut mesatarisht fitojnë më pak dhe janë në rrezik më të lartë të varfërisë në krahasim me burrat. Treguesit në fushën e Kohës tregojnë se janë gratë ato që kryejnë pjesën më të madhe të punës së papaguar në shtëpi dhe në kujdesin e fëmijëve, pavarësisht nga statusi i tyre i punësimit. Pabarazia e shprehur gjimore në ndarjen e punës së papaguar kufizon kohën dhe mundësinë në

dispozicion të grave për të bërë punë të paguar dhe për të arritur sigurinë financiare dhe pavarësinë ekonomike, kufizon mundësinë e pjesëmarrjes së grave në jetën publike, kufizon kohën e tyre për pushim dhe për aktivitete të tjera shoqërore dhe vullnetare.

Rritja e rezultatit të Indeksit në fushën e Pushtetit vjen si rezultat i përmirësimit të pothuajse të gjithë treguesve në nënfushat e pushtetit politik, ekonomik dhe social. Megjithatë, krahasuar me matjen e mëparshme të Indeksit nga viti 2019, rënie ka edhe treguesi i pjesëmarrjes së grave në bordet drejtuese, mbikëqyrëse apo borde drejtuese në shoqëritë më të larta të listuara në bursë në nënfushën e Pushtetit ekonomik. Pas fushës së Kohës, fusha e Pushtetit është fusha e dytë në të cilën vendi regjistron rezultatet më të ulëta, respektivisht pabarazinë më të lartë gjimore. Nga matja e mëparshme e Indeksit, konfirmohet se mungesa e kuotave për pjesëmarrje në të gjitha strukturat qeveritare ndikon në pjesëmarrjen drastike të ulët të grave në pushtetin ekzekutiv dhe vendor dhe në ndarjen jo-proporcionale të pushtetit politik, ekonomik dhe social në dobi të burrave.

Fusha e Shëndetit ka pikën më të lartë të barazisë gjimore në krahasim me fushat e tjera të Indeksit. Megjithatë, kjo fushë nuk mund t'i përfshijë plotësisht të gjitha nivelet përkatëse të pabarazisë në marrjen e shërbimeve shëndetësore në vend, veçanërisht kur bëhet fjalë për shërbimet e shëndetit riprodhues të grave. Ka mungesë të dhënash për aksesin dhe nevojat e paplotësuara për kujdes mjekësor të grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara (për shembull, gratë me aftësi të kufizuara, gratë trans etj.), të cilat shpeshherë përballen me diskriminim interseksional në marrjen e shërbimeve shëndetësore, gjë që e tregojnë rastet ekzistuese të diskriminimit të grave rreth në marrjen e shërbimeve gjinekologjike (Komiteti CEDAW, 2020).

Maqedonia e Veriut ende nuk ka të dhëna të disponueshme që mund të përdoren për të llogaritur treguesin e përbërë për fushën e Dhunës. Në mungesë të të dhënave gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar, Raporti përmbledh një pjesë të rezultateve të anketës për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut të kryer nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në vitin 2019 (OSBE, 2019). Të dhënat tregojnë se dhuna ndaj grave është shumë e përhapur, respektivisht më shumë se gjysma e grave (54 për qind) kanë pësuar një formë dhune që në moshën 15 vjeçare. Në vitin 2022 (gusht-shtator), Enti Shtetëror i Statistikës ka realizuar anketën e parë mbi dhunën me bazë gjimore duke përdorur metodologjinë e Eurostat-it. Anketa do të bëhet çdo pesë vjet, kurse më tej këto të dhëna mund të përdoren edhe për përllogaritjen e fushës së dhunës duke zbatuar metodologjinë e Institutit Europian për Barazi Gjimore (EIGE).



Që nga publikimi i fundit i Indeksit në vitin 2019, vendi ka kaluar nëpër disa reforma dhe ndryshime të rëndësishme në aspektin e politikave dhe proceseve për avancimin e barazisë gjinore, në kontekstin kompleks të pandemisë së virusit COVID-19, fillimit të agresionit ushtarak rus në Ukrainë dhe intensifikimit të lëvizjeve antigjinore (Wittenius, 2022; Cvetković dhe Veličkova, 2022). Pasqyra e ndryshimeve kryesore në legjislacion dhe politika në fushën e barazisë gjinore në vend tregojnë nivel të caktuar progresi në kornizën ligjore dhe strategjike për promovimin e barazisë gjinore në vend. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, pavarësisht progresit në nivel normativ, zbatimi i qëndrueshëm në praktikë mbetet sfida.

Në periudhën në vijim, përmirësimet e politikave janë të domosdoshme për të përmirësuar pozitën e gruas dhe në këtë mënyrë për të reduktuar pabarazitë e rëndësishme gjinore në fushën e punës, parasë, kohës dhe pushtetit. Në Strategjinë për Barazinë Gjinore 2022 - 2027 është parashikuar korniza e përgjithshme për veprimet e institucioneve përkatëse për të përcaktuar më tej politikat dhe masat specifike për përmirësimin e aktivitetit ekonomik të grave, sigurinë financiare, si dhe përmirësimet në shpërndarjen e punës së papaguar në shtëpi dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Për shembull, disa nga rezultatet e pritshme synojnë rritjen e aktivitetit të grave në tregun e punës me fokus gratë e marginalizuara, synojnë uljen e hendekut gjinor të pagave, uljen e ndarjes sektoriale dhe hierarkike në vendin e punës, si dhe vendosjen e masave të ekuilibrit ndërmjet jetës private dhe të punës në përputhje me Direktivën e BE-së 2019/1158 për balancën e jetës së punës dhe asaj private, si dhe masat e ndjeshme gjinore në kohë krize dhe situatash emergjente (Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 170/2022). Megjithatë, qëllimet strategjike në Strategji janë të përkufizuara gjerësisht dhe mungojnë synimet specifike dhe institucionet kompetente drejtpërsëdrejti për qëllimet, gjë që mund të jetë sfida në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e progresit të arritur drejt qëllimeve të parapara strategjike.

Reformat e nevojshme për pushimin e përbashkët prindëror, paga të barabarta për punë të barabartë dhe punë me vlerë të barabartë, si dhe dispozitat për balancën punë-jetë, janë ende të pasigurta për shkak të procesit në vazhdim të hartimit të Ligjit të ri të Punës.

Për sa i përket fushës së Pushtetit, Strategjia për Barazi Gjinore 2022 - 2027 (Gazeta Zyrtare e RMV-së, Nr. 170/2022) e thekson angazhimin strategjik 50:50 për pjesëmarrje të barabartë të grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet e menaxhimit. Megjithatë nevojiten masa shtesë (siç janë kuotat) për të siguruar rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në pushtetin ekzekutiv dhe vendor. Gjithashtu, si kandidatë për anëtarësim në BE, Maqedonia e Veriut duhet të ndjekë dispozitat e Direktivës së BE-së 2022/2381 të miratuar së fundmi për përmirësimin e barazisë gjinore në strukturat menaxhuese të kompanive të listuara në bursa, duke vendosur një kuotë minimale prej 40% të përfaqësimit të pozitave në borde të rezervuara për gjininë më pak të përfaqësuar.<sup>9</sup>

Përmirësimet në politikat dhe kornizën ligjore të vendit në përputhje me Konventën e Stambollit mundësuan përshkrimin e standardeve të domosdoshme për mbrojtjen, parandalimin, trajtimin dhe eliminimin e formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Megjithatë, progresi varet nga zbatimi konsekuent dhe efektiv i dispozitave të përcaktuara ligjore nga të gjitha institucionet kompetente, i shoqëruar nga mjetet e nevojshme buxhetore për zbatimin, si dhe nga monitorimi dhe evaluimi i vazhdueshëm i progresit.

<sup>9</sup> Direktiva e BE-së 2022/2381 për përmirësimin e balancës gjinore ndërmjet drejtorëve/drejtoreshave të kompanive që kuotojnë në bursa (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, 2022)



# Aneksi 1

## Përlllogaritja e Indeksit për Barazi Gjinore sipas fushave dhe nënfushave

### 1. PUNA (fushë)

PJESËMARRJA (nënfushë): Ekuivalenca e kohës së plotë të punës, shkalla e punësimit (popullata 15+)			
Tregues	Ekuivalenca e kohës së plotë të punës, shkalla e punësimit (popullata 15+) Përshkrimi: Njësi matëse për të punësuarit në një mënyrë që i bën ata të krahasueshëm, edhe pse ata punojnë orë të ndryshme në javë. Fitohet duke krahasuar numrin mesatar të orëve të punës të çdo punësuarit me numrin mesatar të orëve të punës të një të punësuarit me kohë të plotë. Pra, një i punësuar me kohë të plotë pune konsiderohet një njësi, ndërsa të punësuarit me orar të shkurtuar pune marrin një koeficient në varësi të numrit të orëve të punës. Për shembull, një i punësuar me kohë të shkurtuar pune që punon 20 orë në javë, kur një i punësuar me kohë të plotë pune punon 40 orë në javë, merr një koeficient 0.5.		
Burimi	Anketa e Fuqisë Punëtore, përlllogaritje shtesë të ESHS		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	32,5	49,0	40,8
2019	35,9	54,2	45,0

PJESËMARRJA (nënfushë): Kohëzgjatja e jetës së punës			
Tregues	Kohëzgjatja e jetës së punës (vite) Përshkrimi: Kohëzgjatja e jetës së punës është një masë që tregon se sa vite pritet që 15-vjeçarët të jenë aktivë në tregun e punës gjatë jetës së tyre. Ky tregues është llogaritur me një model probabiliteti që kombinon të dhënat demografike (Tabelat e Jetës) dhe të dhënat e tregut të punës (normat e aktivitetit sipas grupmoshave nga Anketa e Fuqisë Punëtore).		
Burimi	Tabelat jetësore dhe Anketa e Fuqisë Punëtore, ky tregues tashmë është përlllogaritur dhe publikuar në ueb faqen e Eurostat-it, tabela "Kohëzgjatja e jetës së punës [lfsi_dwl_a]"; <a href="http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=lfsi_dwl_a&amp;lang=en">http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=lfsi_dwl_a&amp;lang=en</a>		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	25,1	36,9	31,2
2019	26,4	36,8	31,7

**NDARJA/SEGREGACIONI DHE CILËSIA E PUNËS (nënfushë):  
Punonjës në arsim, shëndetësi dhe çështje sociale (popullata 15+)**

Tregues Punonjës në arsim, shëndetësi dhe çështje sociale (popullata 15+)  
Përshkrimi: Punonjës në arsim, shëndetësi dhe çështje sociale (popullata 15+) si përqindje e numrit të përgjithshëm të punonjësve sipas KKV Rev 2.

Burimi Anketa për Fuqinë Punëtore, Tabela e Eurostat-it.  
[https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/lfsa\\_egan2/default/Tabela?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/lfsa_egan2/default/Tabela?lang=en)

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	19,0	5,9	11,1
2019	20,0	5,7	11,5

**NDARJA/SEGREGACIONI DHE CILËSIA E PUNËS (nënfushë):  
Mundësia për të marrë një ose dy orë pushim gjatë orarit të punës për arsye personale ose familjare (% , popullata 15+)**

Tregues Përshkrimi: Pyetja 43 (në EWCS, 2010), respektivisht pyetja 47 (në EWCS, 2015). A do të kishit thënë se organizimi për të marrë një ose dy orë pushim gjatë orarit të punës për të bërë disa punë personale ose familjare është... 1. Shumë i lehtë; 2. Deri diku i lehtë; 3. Deri diku i vështirë; 4. Shumë i vështirë. Treguesi paraqet përqindjen e njerëzve që u përgjigjën 1. Shumë lehtë nga të gjithë ata që iu përgjigjën pyetjes dhe zgjodhën modalitetin 1, 2, 3 ose 4.

Burimi Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës (EWCS) 2015  
<https://www.eurofound.europa.eu/surveys/european-working-conditions-surveys>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	41,1	44,2	42,9

**NDARJA/SEGREGACIONI DHE CILËSIA E PUNËS (nënfushë):  
Indeksi i perspektivës në karrierë (prej 0 deri 100 pikë)**

Tregues Përshkrimi: Ky indeks është një nga Indekset e cilësisë së punës, i zhvilluar nga Eurofound. Në Indeks kombinohen treguesit e statusit të punësimit (i vetëpunësuar ose i punësuar), lloji i kontratës së punës, perceptimi i punonjësit për perspektivat e avancimit në punë dhe perceptimi i probabilitetit për humbjen e vendit të punës. Matet në një shkallë nga 0 në 100 ku vlera më e lartë tregon cilësi më të lartë të punës (perspektiva e karrierës). Për marrjen e metodologjisë së saktë duhet t'i drejtoheni Eurofondit.

Burimi Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës (EWCS, 2015),  
<https://www.eurofound.europa.eu/surveys/european-working-conditions-surveys>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	65,9	64,5	65,1

## 2. PARATË (fushë)

BURIMET FINANCIARE (nënfushë): Fitimet mesatare mujore - KKV. Rev.2, sektorët nga B deri në O, pa sektorin L (Standardi i Fuqisë Blerëse)			
Tregues	Përshkrimi: Fitimet mesatare mujore sipas Standardit të Fuqisë Blerëse në sektorët nga B deri në O, duke përjashtuar sektorin L (të gjitha grupmoshat, të punësuar që punojnë në biznese me 10 ose më shumë punonjës).		
Burimi	Anketa mbi strukturën e fitimeve, treguesi tashmë është përlogaritur dhe publikuar në ueb faqen e Eurostat-it.		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	1003	1108	1061
2018	1067	1275	1176

BURIMET FINANCIARE (nënfushë): Të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara (Standardi i Fuqisë Blerëse, popullata 16+)			
Tregues	<p>Të ardhurat mesatare neto ekuivalente (Standardi i Fuqisë Blerëse, popullata 16+)</p> <p>Përshkrimi: Të ardhurat e disponueshme ekuivalente, sipas Standardit të Fuqisë Blerëse, janë të ardhurat totale të familjes, pas taksave dhe zbritjeve të tjera, që janë të disponueshme për konsum ose kursim, pjesëtuar me numrin e anëtarëve të familjes, të konvertuar në të rritur të barabartë; anëtarët e familjes barazohen ose bëhen ekuivalente duke vlerësuar secilin sipas moshës, duke përdorur të ashtuquajturën shkallë të modifikuar ekuivalente të OECD-së. Të ardhurat e disponueshme ekuivalente përlogariten në tre hapa:</p> <p>* Mblidhen të gjitha të ardhurat monetare të fituara nga çdo burim, nga secili anëtar i familjes; këtu bëjnë pjesë të ardhurat nga puna, investimet dhe përfitimet sociale, plus çdo të ardhur tjetër të familjes; nga kjo shumë hiqen taksat dhe kontributet e paguara sociale;</p> <p>* Për të pasqyruar ndryshimet në madhësinë dhe përbërjen e familjes, të ardhurat totale (neto) të familjes pjesëtohen me numrin e "të rriturve ekuivalent", duke përdorur një shkallë standarde të ekuivalencës: shkallën e modifikuar e OECD; kjo shkallë u jep peshë të gjithë anëtarëve të familjes (dhe më pas i shton për të arritur madhësinë ekuivalente të familjes): 1.0 për të rriturin e parë; 0,5 për personin e dytë dhe çdo person i radhës i 14 vjeç e lart; 0.3 për çdo fëmijë nën 14 vjeç.</p> <p>* Në fund, rezultati i fituar i përfaqëson të ardhurat e disponueshme ekuivalente dhe i atribuohet në mënyrë të barabartë secilit anëtar të familjes.</p>		
Burimi	Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, treguesi tashmë është përlogaritur dhe publikuar në ueb faqen e Eurostat-it. <a href="https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_di03/default/Tabela?lang=en">https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_di03/default/Tabela?lang=en</a>		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	5359	5434	5397
2019	6241	6360	6300

**SITUATA EKONOMIKE (nënfushë):****Mosekspozimi ndaj rrezikut të varfërisë, ≥60% e të ardhurave mesatare (% , popullata 16+)**

Tregues	Mosekspozimi ndaj rrezikut të varfërisë, ≥60% e të ardhurave mesatare (% , popullata 16+) Përshkrimi: Treguesi llogaritet si "100 - shkalla e varfërisë". Shkalla e varfërisë është përqindja e personave me të ardhura të disponueshme ekuivalente (pas transfertave sociale) nën kufirin e varfërisë në popullsinë 16 vjeç e lart. Pragu është i barabartë me 60% të të ardhurave mesatare kombëtare ekuivalente të personave që jetojnë në familje.
Burimi	Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, treguesi tashmë është përlogaritur dhe publikuar në ueb faqen e Eurostat-it , tabela "Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas kufirit të varfërisë, moshës dhe gjinisë [ilc_li02]" <a href="https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI02/default/Tabela?lang=en">https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI02/default/Tabela?lang=en</a>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	79,9	80,1	80,0
2019	79,5	79,8	79,6

**SITUATA EKONOMIKE (nënfushë):****S20/80 raporti i kuintilit të të ardhurave (% , popullata 16+)**

Tregues	S20/80 raporti i kuintilit të të ardhurave (% , popullata 16+) Përshkrimi: Treguesi llogaritet si $100 \times \frac{S80}{S20}$ raporti i kuintilit të të ardhurave $\times 100$ . Raporti i kuintilit të të ardhurave S80/S20 është një masë e shpërndarjes së pabarabartë të të ardhurave dhe përfaqëson raportin midis shumës së të ardhurave më të larta ekuivalente të 20% të popullsisë (kuintili më i lartë) dhe shumës së të ardhurave më të ulëta ekuivalentepre 20% të popullsisë (kuintili më i ulët).
Burimi	Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, treguesi tashmë është përlogaritur dhe publikuar në ueb faqen e Eurostat-it <a href="http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?lang=en&amp;dataset=ilc_di11">http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?lang=en&amp;dataset=ilc_di11</a>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	15,2	15,2	15,2
2019	18,0	18,0	18,0

### 3. DIJET (fushë)

Arsimi i përfunduar dhe pjesëmarrja (nënfushë): Persona me arsim të lartë (terciar) të përfunduar (% , popullata 15+)			
Tregues	Persona me arsim të lartë (terciar) të përfunduar (% , popullata 15+) Përshkrimi: Personat që kanë përfunduar arsimin terciar (nivelet 5 deri në 8 sipas ISCED) si përqindje e popullsisë së përgjithshme 15+.		
Burimi	Anketa për Fuqinë Punëtore, ESHS		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	17,1	15,0	16,0
2019	18,5	16,8	17,6

Arsimi i përfunduar dhe pjesëmarrja (nënfushë): Personat që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal ose joformal (% , popullata 15+)			
Tregues	Personat që marrin pjesë në arsimin dhe trajnimin formal ose joformal (% , popullata 15+) Përshkrimi: Të mësuarit gjatë gjithë jetës përfshin të gjitha aktivitetet e të nxëniet të qëllimshëm, qofshin ato formale, joformale apo informative, të ndërmarrja në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim të avancimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave. Periudha referuese për pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim është katër javët e fundit para anketës në Anketën e Fuqisë Punëtore.		
Burimi	Anketa për Fuqinë Punëtore, ESHS		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	12,5	12,3	12,4
2019	12,1	11,7	11,9

Arsimi i përfunduar dhe pjesëmarrja (nënfushë): Studentë në arsimin e lartë (terciar) në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe çështjeve sociale, shkencave humane dhe arteve – nivelet nga 5 deri në 8 sipas ISCED (% , studentët në arsimin e lartë)			
Tregues	Studentë në arsimin e lartë (terciar) në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe çështjeve sociale, shkencave humane dhe arteve – nivelet nga 5 deri në 8 sipas ISCED (% , studentët në arsimin e lartë) Përshkrimi: Treguesi është përlllogaritur si përqindje e studentëve në arsimin e lartë (terciar) në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe çështjeve sociale, shkencave humane dhe arteve nga të gjithë studentët që ndjekin arsimin e lartë (terciar).		
Burimi	Statistika e Arsimit, Tabela e Eurostat-it "Studentët e përfshirë në arsimin e lartë, sipas nivelit të arsimit, orientimit programor, gjinisë dhe fushës së arsimit [educ_uae_enrt03]", <a href="https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=educ_uae_enrt03&amp;lang=en">https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=educ_uae_enrt03&amp;lang=en</a>		
Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	39,9	22,9	32,1
2019	45,1	26,1	36,8

#### 4. KOHA (fushë)

##### Aktivitetet e kujdesit (nënfushë):

Personat që kujdesen dhe që janë të përfshirë në edukimin e fëmijëve ose nipërve të tyre, të rriturve ose personave me aftësi të kufizuara, çdo ditë (% , popullata 18+)

**Tregues** Përqindja e personave të përfshirë në të paktën në një nga këto aktivitete të kujdesit gjatë ditës që nuk janë rezultat i punës së paguar: kujdesi për fëmijët, nipërit, të rriturit dhe personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mbështetje. Pyetje: (e përgjithshme) Sa shpesh përfshihen në ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme jashtë orarit të punës me pagesë? Viti 2016: Q42a. Kujdesi dhe/ose edukimi i fëmijëve tuaj; Q42b. Kujdesi dhe/ose edukimi i nipërve tuaj; Q42d. Kujdesi për personat me aftësi të kufizuara ose personat që kanë nevojë për mbështetje, të cilët janë pjesë e familjes, fqinjëve ose miqve tuaj nën moshën 75 vjeç; Q42e Kujdesi për personat me aftësi të kufizuara ose njerëzit që kanë nevojë për mbështetje që janë pjesë e familjes, fqinjëve ose miqve tuaj të moshës 75 vjeç vite e më shumë; viti 2012: Q36a. Kujdesi për fëmijët/nipërit tuaj; Q3bc. Kujdesi për të rriturit ose personat me aftësi të kufizuara që janë të afërmit tuaj; viti 2007: Q36c. Kujdesi për të rriturit ose personat me aftësi të kufizuara që janë të afërmit tuaj; viti 2003: Q37a. Kujdesi dhe edukimi i fëmijëve; Q37c. Kujdesi për të rriturit ose personat me aftësi të kufizuara që janë të afërmit tuaj.

**Burimi** Eurofound, Sondazhi Evropian për Cilësinë e Jetës (EQLS, 2016)  
<https://www.eurofound.europa.eu/surveys/european-quality-of-life-surveys/european-quality-of-life-survey-2016>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2016	39,3	29,9	34,6

##### Aktivitetet e kujdesit (nënfushë):

Personat e përfshirë në gatim dhe/ose punët e shtëpisë, çdo ditë (% , popullata 18+)

**Tregues** Përqindja e personave të përfshirë në gatim dhe/ose punë shtëpie gjatë ditës që nuk është rezultat i punës së paguar. Pyetje: Sa shpesh përfshihen në ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme jashtë orarit të punës me pagesë? Viti 2016: P42c. Gatimi dhe/ose punët e shtëpisë; viti 2012 P36b. Gatimi dhe/ose punët e shtëpisë; viti 2007: P36b. Gatimi dhe punët e shtëpisë; viti 2003: P37b. Punët e shtëpisë.

**Burimi** Eurofound, Sondazhi Evropian për Cilësinë e Jetës (EQLS, 2016)  
<https://www.eurofound.europa.eu/surveys/european-quality-of-life-surveys/european-quality-of-life-survey-2016>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2016	71,1	10,4	41,0

**Aktivitetet sociale (nënfushë): Punonjës që kanë kohë për aktivitete sportive, kulturore ose argëtuese jashtë shtëpisë së tyre, të paktën çdo ditë ose disa herë në javë (% punonjës 15+)**

Punonjës që kanë kohë për aktivitete sportive, kulturore ose argëtuese jashtë shtëpisë së tyre, të paktën çdo ditë ose disa herë në javë (% punonjës 15+)

Përshkrimi: Pyetja EF2g (në EWCS, 2010), përkatësisht pyetja 95g (në EWCS, 2015). Në përgjithësi, sa shpesh merreni me aktivitete sportive, kulturore apo argëtuese jashtë shtëpisë tuaj, jashtë punës? 1. Çdo ditë; 2. Disa herë në javë; 3. Disa herë në muaj; 4. Më rrallë; 5. Asnjëherë. Treguesi përfaqëson përqindjen e personave që janë përgjigjur me modalitetet 1 dhe 2 në EWCS, 2015), të të gjithë atyre që janë përgjigjur në pyetjen dhe (modalitetet 1-5, nga 1-6 në EWCS, 2010).

Burimi Eurofound, Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës (EWCS) 2015  
<https://www.eurofound.europa.eu/surveys/european-working-conditions-surveys/sixth-european-working-conditions-survey-2015>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	13,3	16,4	15,1-

**Aktivitetet sociale (nënfushë): Punonjës që kanë kohë për veprimtari vullnetare ose bamirëse, të paktën një herë në muaj (% punonjës 15+)**

Punonjës që kanë kohë për veprimtari vullnetare ose bamirëse, të paktën një herë në muaj (% punonjës 15+)

Përshkrimi: Pyetja EF2a (në EWCS, 2010), përkatësisht pyetja 95a (në EWCS, 2015). Në përgjithësi, sa shpesh përfshihen në aktivitete vullnetare ose bamirëse jashtë punës? 1. Çdo ditë; 2. Disa herë në javë; 3. Disa herë në muaj; 4. Më rrallë; 5. Asnjëherë. Treguesi përfaqëson përqindjen e personave që janë përgjigjur me modalitetet 1-3 nga modalitetet 1-5 në EWCS, 2015, respektivisht (modaliteti 1-4 në EWCS, 2010), të të gjithë atyre që iu përgjigjën pyetjes (kanë zgjedhur nga të gjitha përgjigjet 1 -6 në EWCS, 2010).

Burimi Eurofound, Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës (EWCS) 2015, <https://www.eurofound.europa.eu/surveys/european-working-conditions-surveys/sixth-european-working-conditions-survey-2015>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	16,6	22,9	20,2

## 5. PUSHTETI (fushë)

<b>Pushteti politik (nënfushë): Pjesëmarrja e ministrave (%)</b>	
Tregues	Pjesëmarrja e ministrave Përshkrimi: Treguesi është përlogaritur si pjesëmarrje e ministrave në popullsinë totale të vendit 18+ vjeç.
Burimi	Të dhënat janë në dispozicion në data-bazën e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) për gratë dhe burrat në procesin e vendimmarrjes: <a href="http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm">http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm</a>

Viti	Gra	Burra	Githsej
Mesatarja 3-vjeçare (2014-2015-2016)	11,5	88,5	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	14,7	85,3	100

<b>Pushteti politik (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në Parlament (%)</b>	
Tregues	Pjesëmarrja e anëtarëve në Parlament (%) Përshkrimi: Treguesi është përlogaritur si pjesëmarrje e anëtarëve në Parlament në popullatën e përgjithshme në vend të moshës 18+.
Burimi	Të dhënat janë në dispozicion në data-bazën e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) për gratë dhe burrat në procesin e vendimmarrjes: <a href="http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm">http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm</a>

Viti	Gra	Burra	Githsej
Mesatarja 3-vjeçare (2014-2015-2016)	34,8	65,2	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	38,3	61,7	100

<b>Pushteti politik (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në politikë në nivel lokal (%)</b>	
Tregues	Pjesëmarrja e anëtarëve në politikë në nivel lokal (%) Përshkrimi: Treguesi është përlogaritur si pjesëmarrje e anëtarëve në politikë në nivel lokal në popullatën e përgjithshme në vend të moshës 18+.
Burimi	Të dhënat janë në dispozicion në data-bazën e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) për gratë dhe burrat në procesin e vendimmarrjes: <a href="http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm">http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm</a>

Viti	Gra	Burra	Githsej
Mesatarja 3-vjeçare (2014-2016)	28,8	71,2	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	32,4	67,6	100



**Pushteti ekonomik (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në Borde drejtuese, Mbikëqyrëse ose Borde të Drejtorëve në kompanitë e listuara lartë (%)**

**Tregues** Pjesëmarrja e anëtarëve në borde drejtuese, borde mbikëqyrëse ose borde të drejtorëve në kompanitë e listuara lartë (%)  
Përshkrimi: Treguesi është përlogaritur si pjesëmarrje e anëtarëve në Borde drejtuese, Mbikëqyrëse ose Borde të Drejtorëve në kompanitë e listuara lartë në numrin e përgjithshëm të popullatës më vend të moshës 18+.

**Burimi** Të dhënat janë në dispozicion në data-bazën e Institutit Europian për Barazi Gjinore (EIGE) për gratë dhe burrat në procesin e vendimmarrjes:  
<http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm>

Viti	Gra	Burra	Githsej
Mesatarja 3-vjeçare (2014-2015-2016)	20,5	79,5	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	19,1	80,9	100

**Pushteti ekonomik (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në Bankën Qendrore (%)**

**Tregues** Pjesëmarrja e anëtarëve në Bankën Qendrore (%)  
Përshkrimi: Treguesi është përlogaritur si pjesëmarrje e anëtarëve në Bankën Qendrore në popullatën e përgjithshme në vend të moshës 18+.

**Burimi** Të dhënat janë në dispozicion në data-bazën e Institutit Europian për Barazi Gjinore (EIGE) për gratë dhe burrat në procesin e vendimmarrjes:  
<http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm>

Viti	Gra	Burra	Githsej
Mesatarja 3-vjeçare (2014-2015-2016)	24,0	76,0	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	32,0	68,0	100

**Pushteti ekonomik (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në organet drejtuese të organizatave/institucioneve për financimin e hulumtimeve (%)**

**Tregues** Përshkrimi: Pjesëmarrja e anëtarëve më të lartë në organet drejtuese të organizatave/institucioneve për financimin e hulumtimeve. Përlogaritje të bazuara në mesataren trevjeçare dhe raportin gra/burra në popullatën 18+

**Burimi** EIGE; <https://eige.europa.eu/gender-statistics>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2016	42,9	57,1	100
2019	51,9	48,1	100

**Pushteti social (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në organet drejtuese të organizatave kombëtare radiodifuzive (%)**

**Tregues** Pjesëmarrja e anëtarëve në organet drejtuese të organizatave kombëtare radiodifuzive. Përlogaritje të bazuara në mesataren trevjeçare dhe raportin gra/burra në popullatën 18+

**Burimi** Të dhënat janë në dispozicion në data-bazën e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) për gratë dhe burrat në procesin e vendimmarrjes:  
<http://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm>

Viti	Gra	Burra	Githsej
Mesatarja 3-vjeçare (2015-2016-2017)	46,2	53,8	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	46,2	53,8	100

**Pushteti social (nënfushë): Pjesëmarrja e anëtarëve në organet drejtuese të organizatave kombëtare sportive olimpike (%)**

**Tregues** Pjesëmarrja e anëtarëve në organet drejtuese të 10 organizatave kombëtare më të popullarizuara sportive olimpike. Përlogaritje të bazuara në mesataren trevjeçare dhe raportin gra/burra në popullatën 18+

**Burimi** ESHS

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	8,9	91,1	100
Mesatarja 3-vjeçare (2018-2019-2020)	9,2	90,8	100

## 6. SHËNDETI (fushë)

### Statusi (nënfushë): Perceptimi personal i gjendjes së përgjithshme shëndetësore, të mirë ose shumë të mirë (% , popullata 16+)

**Tregues** Perceptimi personal i gjendjes së përgjithshme shëndetësore, të mirë ose shumë të mirë (% , popullata)  
Përshkrimi: Treguesi përlllogaritet si përqindje e njerëzve që e vlerësojnë gjendjen e tyre shëndetësore si "shumë mirë" dhe "mirë". Koncepti i perceptimit personal të gjendjes së përgjithshme shëndetësore zbatohet duke pyetur se si një person e shikon gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore, duke u përgjigjur me një nga modalitetet e mëposhtme: shumë mirë, mirë, kënaqshëm, keq dhe shumë keq.

**Burimi** Anketa për të hyrat dhe kushtet e jetesës, Tabela e Eurostat-it „Perceptimi personal mbi shëndetin sipas gjinisë, moshës dhe statusit të punës [hlth\_silc\_01]“  
[http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=hlth\\_silc\\_01](http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=hlth_silc_01)

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	74,4	79,8	77,1
2019	71,7	77,6	74,6

### Statusi (nënfushë): Jetëgjatësia e pritur absolute në lindje (vite)

**Tregues** Jetëgjatësia e pritur absolute në lindje (vite)  
Përshkrimi: Jetëgjatësia e pritur është përlllogaritur bazuar në të dhënat e mortalitetit. Totali përlllogaritet si një mesatare e të dhënave për burrat dhe gratë.

**Burimi** Tabela e Eurostat „ Jetëgjatësia e pritur në lindje sipas gjinisë dhe moshës [DEMO\_MLEXPEC\_\_custom\_1878841]“  
[https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/DEMO\\_MLEXPEC\\_\\_custom\\_1878841/default/Tabela](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/DEMO_MLEXPEC__custom_1878841/default/Tabela)

Viti	Gra	Burra	Githsej
2014	77,4	73,5	75,5
2019	78,6	74,7	76,6

### Statuasi (nënfushë): Vite jete të shëndetshme në vlerë absolute në lindje (vite)

Vite jete të shëndetshme në vlerë absolute në lindje (vite)

Përshkrimi: Totali llogaritet si një mesatare e të dhënave për burrat dhe gratë. Vitet e jetës së shëndetshme përfaqësojnë numrin e viteve të mbetura që një person i një moshe të caktuar pritet të jetojë pa ndonjë problem shëndetësor serioz ose mesatar. Ky është një tregues i përbërë që kombinon të dhënat e vdekshmërisë me të dhënat shëndetësore nga Anketa e të ardhurave dhe kushtet e jetesës: një pyetje vetë-raportuese që synon të masë shkallën në të cilën çdo kufizim, që zgjat të paktën 6 muaj, i vështirëson aktivitetet e përditshme të të anketuarit. Përlllogaritet duke përdorur metodën Sullivan duke kombinuar të dhënat e mortalitetit dhe situatës shëndetësore. 1. Variablat e përdorur për komponentin e vdekshmërisë: Shkalla specifike e vdekshmërisë sipas moshës, probabiliteti i vdekjes midis grupmoshave, probabiliteti i mbijetesës midis grupmoshave, numri i të mbijetuarve në një moshë specifike, vitet e jetës midis grupmoshave, jetëgjatësia e pritur e moshës specifike.

2. Variablat e përdorur për statusin shëndetësor: pyetja e Anketës për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, a i vështirësojnë problemet shëndetësore që zgjasin të paktën gjashtë muaj aktivitetet tuaja të përditshme? Në këtë mënyrë përcaktohet përfaqësimi i popullatës në kushte të shëndetshme (ata që janë përgjigjur "Jo, në mënyrë të pakufizuar") dhe në kushte jo të shëndetshme (ata që janë përgjigjur "Po, në mënyrë të kufizuar" dhe "Po, në masë të madhe").

Burimi Të dhëna mbi mortalitetin, Anketa për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, ESHS përlllogaritje

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	66,5	65,4	66,0
2019	65,4	65,8	65,6

### Sjellja/Shprehitë (nënfushë): Përqindja e njerëzve që nuk pinë duhan dhe nuk janë konsumatorë të tepërt të alkoolit (% popullata 16+)

Tregues Përqindja e personave që nuk përfshihen në sjellje të rrezikshme, respektivisht nuk pinë duhan dhe nuk janë të përfshirë në konsumimin e shpeshtë të alkoolit. Konsumimi i shpeshtë i alkoolit nënkupton pirjen e gjashtë pijeve ose 60+ gram alkool të pastër në një rast, në muaj ose më shumë se një herë, në 12 muajt e fundit. Pije konsiderohet një gotë verë, një gotë birrë, një gotë uiski etj. Kushdo që është i përfshirë në pirjen ose konsumimin e shpeshtë të alkoolit konsiderohet se ka një sjellje e rrezikshme.

Burimi ESHS simulime

Viti	Gra	Burra	Githsej
2014	73,4	36,2	55,4

**Sjellja/Shprehitë (nënfushë): Përqindja e njerëzve që janë fizikisht aktivë për të paktën 150 minuta në javë dhe konsumojnë të paktën pesë porcione frutash dhe perimesh në ditë (% , popullata 16+)**

**Tregues** Përqindja e njerëzve që janë fizikisht aktivë për të paktën 150 minuta në javë dhe/ose konsumojnë të paktën pesë racione frutash dhe perimesh në ditë. Këto aspekte janë pjesë e rekomandimeve zyrtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Eurostat-i siguron informacione mbi kohën e shpenzuar për përmirësimin e shëndetit (që nuk lidhet me punën) si aktiviteti fizik aerobik (në minuta në javë), përfshirë sportin dhe çiklizmin si mjet transporti. Pesë racione (400 gram) fruta dhe perime nuk përfshijnë koncentre të lëngjeve të frutave dhe patate (niseshte).

**Burimi** SSO simulations

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	93,1	94,7	93,9
2019	95,1	95,1	95,1

**Aksesi (nënfushë): Persona pa nevojë të paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar (% , popullata)**

**Tregues** Persona pa nevojë të paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar (% , popullata)  
Përshkrimi: Treguesi përlogarit si përqindje e personave që janë përgjigjur "Jo, nuk ka pasur një rast të tillë" në pyetjen: A keni pasur nevojë për dentist gjatë 12 muajve të fundit?? Nga anketa për të ardhurat dhe kushtet e jetesës, nga të gjithë të anketuarit që janë përgjigjur, nga të gjitha grupet e të ardhurave.

**Burimi** Anketa për të hyrat dhe kushtet e jetesës, të dhëna sipas gjinisë të publikuara në ueb faqen e Eurostat-it në tabelën Self-reported unmet needs for dental examination by sex, age, detailed reason and income quintile (%) [hlth\_silc\_09] [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/HLTH\\_SILC\\_09/default/Tabela?lang=en&category=hlth.hlth\\_care.hlth\\_unm](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/HLTH_SILC_09/default/Tabela?lang=en&category=hlth.hlth_care.hlth_unm)

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	96,0	95,7	95,9
2019	96,0	95,6	95,8

**Variabla shtesë që përdoren gjatë përlogaritjes së Indeksit**

**Tregues** Popullata 18+

**Burimi** Vlerësime të popullatës, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.10.pdf>

Viti	Gra	Burra	Githsej
2015	814691	804809	1.0000
2019	838219	827762	1.0000

# Referenca

- Babovic, M., and Petrovic, M. (2021). Gender Equality Index for the Republic of Serbia 2021. Social Inclusion and Poverty Reduction Unit of the Government of the Republic of Serbia, e disponueshme në: <https://eurogender.eige.europa.eu/events/release-gender-equality-index-serbia-2021#res>
- European Institute for Gender Equality. Gender Statistics Database, Women and men in decision-making, e disponueshme në: <https://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs> [accessed 29.10.2022].
- European Union Agency for Fundamental Rights. (2014). Violence against women: an EU-wide survey — Main results, Publications Office of the European Union, Luxembourg, e disponueshme në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>
- Eurostat. (2022). Distribution of students enrolled at tertiary education levels by sex and field of education, e disponueshme në: [https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/educ\\_uoe\\_enrt04](https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/educ_uoe_enrt04) [accessed 18.09.2022]
- Eurostat. (2022). Employment and activity by sex and age – annual data, e disponueshme në: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/main/data/database> [accessed 15.9.2022]
- Global Voices: „Private abuse in Telegram’s ‘Public Rooms’: Can North Macedonia fight online sexual harassment?”, published 8-9 February 2022, e disponueshme në: <https://advox.globalvoices.org/2022/02/08/private-abuse-in-telegrams-public-rooms-can-north-macedonia-fight-online-sexual-harassment/> [accessed 02.04.2023]
- INSTAT. (2020). Gender Equality Index for the Republic of Albania 2020, e disponueshme në: [http://www.instat.gov.al/media/6661/gender\\_equality\\_index\\_for\\_the\\_republic\\_of\\_albania\\_2020.pdf](http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf)
- Komar, O. (2019). Gender Equality Index Montenegro 2019. MONSTAT, e disponueshme në: [https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender\\_equality\\_index\\_2019\\_report\\_final.pdf](https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_2019_report_final.pdf)
- Kodi Penal. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 37/96; 80/99; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/11; 135/11; 185/11; 142/12; 166/12; 55/13; 82/13; 14/14; 27/14; 28/14; 115/14; 132/14; 160/14; 199/14; 196/15; 226/15; 97/17 dhe 248/18; Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 36/2023.
- Leshovska, V. dhe të tjerë (2022). Diskriminimi i bazuar në gjini dhe të drejtat e punëtorëve në Maqedoninë e Veriut. Reaktor – Hulumtimi në Aksion, në dispozicion në <https://reactor.org.mk/publication-all/родово-базирана-дискриминација-ипаб-2/>
- Ministria e Mbrojtjes. (2020). Plani Kombëtar i Veprimit për implementimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1325 “Gratë, paqëja dhe siguria” 2020-2025, në dispozicion në <https://www.mod.gov.mk/стратешки-документи/#1622706201131-dcc1a5e8-5e86>
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. (2021). Plani Kombëtar i Veprimit për Mbrojtjen, Promovimin dhe Përbushjen e të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Femrave Rome 2022-2024, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspk>
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. (2018). Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspk>
- OSCE. (2019). OSCE-led survey on violence against women. Well-being and safety of women: North Macedonia, e disponueshme në: <https://www.osce.org/secretariat/419264>
- Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 84/13; 13/14; 44/14; 101/14; 132/14; 142/16; 132/17; 168/18; 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/20, në dispozicion në <https://avmu.mk/zakon-za-audio-i-audiovizuelni-mediumi/>

- Ligji për Ndhimë Juridike Falas. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 101/19, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/zakoni.nspk>
- Ligji për Mundësi të Barabarta të Femrave dhe Meshkujve. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 6/12 dhe 150/2015, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspk>
- Ligji për Mbrojtje nga Shqetësimi në Vendin e Punës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 79/13, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/zakoni.nspk>
- Ligji për Rrogë Minimale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 11/12; 30/14; 180/14; 81/15; 129/15; dhe 132/17, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/zakoni.nspk>
- Ligji për Arsim Fillor. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 161/19, Republika e Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në <https://www.mon.gov.mk>
- Ligji për Ndërprerjen e Shtatzënisë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 87/13, në dispozicion në <http://zdravstvo.gov.mk/zakoni-2/>
- Ligji për Ndërprerjen e Shtatzënisë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 101/19, достапен на <http://zdravstvo.gov.mk/zakoni-2/>
- Ligji i Marrëdhënieve të Punës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 62/05; 106/08; 161/08; 114/09; 130/09; 50/10; 52/10; 124/10; 47/11; 11/12; 39/12; 13/13; 25/13; 170/13; 187/13; 113/14; 20/15; 33/15; 72/15; 129/15; 27/16 dhe 120/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 110/19; 267/20 dhe 151/21.
- Ligji i Mbrojtjes Sociale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 104/19, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/zakoni.nspk>
- Ligji i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 258/2020, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspk>
- Ligji i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Dhuna ndaj Femrave dhe Dhunës në Familje. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 24/21, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/zakoni.nspk>
- Ligji për Tekste Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 98/08; 99/09; 83/10; 36/11; 135/11; 46/12; 24/13; 120/13; 29/14; 146/15; 217/15; 30/16 dhe 21/18, në dispozicion në <https://www.mon.gov.mk>
- Programi për Mbështetjen e Sigurisë Sociale të Grave që kryejnë Veprimtari Bujqësore për vitin 2023. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 31/2023, në dispozicion në [https://www.mzsv.gov.mk/Почетна/Документи\\_и\\_информации\\_од\\_јавен\\_карактер/Програми.aspx](https://www.mzsv.gov.mk/Почетна/Документи_и_информации_од_јавен_карактер/Програми.aspx)
- Reaktor – Hulumtimi në Aksion. (2020). Raport në hije mbi implementimin e Strategjisë për Barazi Gjinore në vitin 2018/2019, në dispozicion në <https://reactor.org.mk/en/publication-all/shadow-report-on-the-implementation-of-the-gender-equality-strategy-2018-2019/>
- Robayo-Abril, M. and Millan, N. (2019). Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Western Balkans. World Bank, Washington, DC, e disponueshme në: <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/31393>
- Këshilli i Evropës. (2011). Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, në dispozicion në: <https://rm.coe.int/168046253a>
- Strategjia për Barazi Gjinore 2022 - 2027. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 170/2022, në dispozicion në <https://www.mtsp.gov.mk/zakoni.nspk>
- State Statistical Office and UNICEF. (2020). 2018-2019 North Macedonia Multiple Indicator Cluster Survey and 2018-2019 North Macedonia Roma Settlements Multiple Indicator Cluster Survey, Survey Findings Report. Skopje, North Macedonia: State Statistical Office and UNICEF, e disponueshme në: [https://www.stat.gov.mk/Dokumenti/MICS\\_18-19.pdf](https://www.stat.gov.mk/Dokumenti/MICS_18-19.pdf)

- Cvetković, I., Veličkovića, M. (2022). Kush frikësohet nga gjinia? Analizë e strategjive dhe narrativave kryesore të lëvizjeve antigjinore në Maqedoninë e Veriut. Koalicioni "Margjinat", në dispozicion në [http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/10/koj-se-plashi-od-rodot\\_-interactive.pdf](http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/10/koj-se-plashi-od-rodot_-interactive.pdf)
- Williams, J. C. (2000). *Unbending gender. Why Family and Work Conflict and What to Do About It*. New York: Oxford University Press.
- Wittenius, M. (2022). The transnational anti-gender movement in Europe, e disponueshme në: <https://www.gwi-boell.de/en/2022/02/03/the-transnational-anti-gender-movement-europe>
- World Bank. (2020). *Assessment of barriers and opportunities using Gender and Roma lens in North Macedonia: Case of Transport*. World Bank.
- World Bank. (2017). *Promoting Women's Access to Economic Opportunities*. Policy Note. World Bank.





